



**ΠΑΝΕΠΙΣΤΗΜΙΟ ΑΡΓΥΡΟΚΑΣΤΡΟΥ
ΣΧΟΛΗ ΑΓΩΓΗΣ ΚΑΙ ΚΟΙΝΩΝΙΚΩΝ ΕΠΙΣΤΗΜΩΝ
ΤΜΗΜΑ ΕΛΛΗΝΙΚΗΣ ΓΛΩΣΣΑΣ, ΛΟΓΟΤΕΧΝΙΑΣ ΚΑΙ
ΕΛΛΗΝΙΚΟΥ ΠΟΛΙΤΙΣΜΟΥ**

ΑΡΘΡΑ ΤΩΝ ΚΑΘΗΓΗΤΩΝ ΤΟΥ ΤΜΗΜΑΤΟΣ

(σε διάφορα περιοδικά)

ΑΡΓΥΡΟΚΑΣΤΡΟ 2015

Περιεχόμενα



.....	1
ΠΑΝΕΠΙΣΤΗΜΙΟ ΑΡΓΥΡΟΚΑΣΤΡΟΥ	1
Panajot Barka.....	3
1) Revista periodike “Kërkime Universitare”, Universiteti i Gjirokastrës, nr. 5, 2001	3
“Zhvillimet ekonomiko-shoqërore e kulturore në Shqipëri dhe	3
mjedisi dygjuhësor”	3
Panajot Barka.....	8
2) Revista periodike “Kërkime Universitare” Universiteti i Gjirokastrës, nr. 9, 2004	8
“Polifonia tre-katërzërëshe tregues i një identiteti kulturor multietnik e multigjuhësor”	8
Panajot Barka.....	18
3) Revista periodike “Kërkime Universitare”, Universiteti i Gjirokastrës, nr.13, 2006	18
“Migrimet e Minoritetit Grek dhe marrëdhëniet me	18
popullsinë shqiptare”	18
Panajot Barka.....	26
4) Revista periodike “Kërkime Universitare”, Universiteti i Gjirokastrës, nr. 15, 2008.....	26
“Letërsia e Minoritetit Etnik Grek gjatë Luftës së Dytë Botërore”	26
Kostando Ksera, Harallamb Miconi	33
5) Revista periodike “Kërkime Universitare”, Universiteti i Gjirokastrës, nr. 37, 2014.....	34
“Leksikografia shqiptaro – greke në fjalorin e Niko Gjinit (1971)”	34
Donika Koci.....	42
6) “International Journal of Linguistics”, March 2014	42
“Bilingualism and the alternation of codes in a bilingual environment”	42
Olieta Polo	47
7) “Mediterranean Journal of Social Sciences”, Rome - Italy, Vol 5 No 8, May 2014	47
“The programe, purpose and the objectives of “Llaiko Vima”	47
newspaper (1945-2012)”	47
Olieta Polo	52
8) Revista periodike “Kërkime Universitare”, Universiteti i Gjirokastrës, nr. 37, 2014.....	52
“Llojet e prozës në gazetën “Llaiko Vima” (1945-2012)”	52
Olieta Polo	61
9) “Mediterranean Journal of Social Sciences”, Rome - Italy, Vol 6 No 2 S1, March 2015... 61	
“The Journalistic Categories and Their Structure in the Pages of “Llaiko Vima” Newspaper	
(1945-2012)”	61

Panajot Barka

1) Revista periodike “Kërkime Universitare”, Universiteti i Gjirokastrës, nr. 5, 2001

“Zhvillimet ekonomiko-shoqërore e kulturore në Shqipëri dhe mjedisi dygjuhësor”

Literatura e derisotme e lidh dygjuhësinë në vendin tonë me praninë e minoritetëve dhe në përgjithësi e trajton atë, në menyre njëdimensionale dhe shpesh në një plan të rrafshhtë plotësisht pozitiv d.m.th pa problematikën, pasojë e egzistencës së këtij fenomeni.

Kështu në Jug të vendit dygjuhësia është e lidhur vetëm me praninë e faktorit etnik dhe kongretisht si veti vetëm e Minoritetit Etnik Grek. Po ashtu problemi i dygjuhësisë brenda komunitetit të këtij Minoriteti etnik, trajtohet pa diferencime si për sa i përket ndryshimeve të raportëve cilësore të varietetëve apo të elementëve të dygjuhësisë në periudha të ndryshme kohore, ashtu edhe në varësi të ndikimit të faktorëve të ndryshëm, ekonomik, politik, shoqëror, etnik, etj mbi këto raporte.

Gjithashtu faktorët e tjerë etnik në të njëjtën trevë mbeten jashtë vëmendjës studjuese edhe pse krijojnë fenomene më interesante dygjuhësie. Egzistenca fjala vjen e komuniteteve të tilla etnike si ai i vllahëve dhe veçanarisht ai me prejardhje greke, krijon një fenomen akoma më të spikatur në këtë fushë, atë të një komuniteti trigjuhësor, midis gjuhëve vllahë, greke dhe shqipe. Edhe në këtë komunitet faktori kohë apo dhe të tjerë të përmendur më lart krijojnë një ndryshim analog të raportëve të elementëve gjuhësor nga bartësit e tyre. Kështu kur ky komunitet deri në vitet 60 ishte izoluar zotërohej nga dygjuhësia greko-vllahë e mbartur nga origjina që ishte Greqia. Me integrimin në shoqërinë shqiptare dhe më ndryshimin e marrëdhënieve të punës dhe të jetësës, vihet re një tërheqje e madhe e gjuhës greke, kufizim deri brenda në familje i gjuhës vllahë dhe mbizotërimi i gjuhës shqipe. Raporti i vjetër i ruajt vetëm tek brezi i tretë, kuptohet edhe këtu i ndryshuar.

Në periudhën pas viteve 90 ku kemi një ndryshim të raportëve apo marrëdhënieve ekonomike, ku spikat ndikimi ekonomik i Greqisë, vihet re që në brezat e rinj të riaktivizohet dhe zgjerohet pak sa gjuha vllahë, Gjuha greke merr përmasa më të mëdha dhe shqipja të mbetet në të njëjta pozita në mos të lëshoj terren.

Mëgjithatë duhet thenë se faktori etnik nuk është faktori i vetëm madje bartës i vetëm i dygjuhësisë

Dygjuhësia në një rajon më të gjerë është produkt edhe i ndërveprimit të faktorit ekonomik, tregëtar e kulturor në aspektin diakronik por edhe aktual në një trevë me etni të ndryshme por me nënshtrat të hershëm të përbashkët në shumë drejtime.

Edhe ky faktor, që çon në dygjuhësi të qendrueshme apo të paqendrueshme, kuptohet në varësi të peshës së faktorëve veprues, ka mbetur jashtë vemëndjës së studimëve të kësaj natyre.

Përveç fenomenit të dygjuhësisë ky faktor na sjell përseri një fenomen trigjuhësie siç ndodh në komunitetin e romëve. Nevoja e mbijetesës nëpërmjet lëvizjës së përhershme në rajone me gjuhë të ndryshme i ka bërë ata mbartës të gjuhës së tyre nga njëra anë, të shqipës nga ana tjetër po edhe të greqishtës në një masë të madhe sidomos pas vitëve '90.

Në një optik shkencore të problemit rezulton se fenomeni i dygjuhësisë është i pranishëm në dy nivele së pari brenda një komuniteti etnik dhe së dyti në një formacion më të gjerë dy komunitar. Në të dy rastet peshë, intensiteti dhe ndryshueshmëria e elementëve të dygjuhësisë ose të varietetëve, sipas Gj Shkurtajt, varen kryesisht nga natyra dhe raportet e marrëdhënjëve politike, ekonomiko-shoqërore dhe kulturore të vendosura midis përfaqësuesve të dy gjuhëve.

Në vijim, në varësi të këtyre faktorëve do të mundohemi të japim një pamje të përgjithshme të dygjuhësisë të Minoritetit Etnik Grek në Shqipëri pas Luftës së Dytë Botërore.

Vitet pas 1944

Minoriteti Etnik Grek trashëgoi edhe pas Luftës së dytë botërore realitetin e dygjuhësisë gjeopolitike. Ekuilibri midis varietetëve të ulta dhe të lartë kishte pak a shumë këtë natyrë. Varietetet e ulëta (element amtarë në dygjuhësi) ishin mbisunduese në të gjitha moshat. Varietetet e larta (element të mbivëna, ose gjuha zyrtare shqipe) zinin vetëm marrëdhënjet shtetërore dhe me peshë të pakët në shkollë. Nga pikëpamja gjeografike në zonat me popullsi homogjene të etnisë greke pjesa dermuese e kësaj popullsie jetonte thjesht në një situatë politiko shoqërore dygjuhësie, pa ditur asnjë fjalë në gjuhën zyrtare.

Statusi i dygjuhësisë së mirfilltë haset në ato zona ku anëtarët e etnisë greke bashkëjetonin me etninë shqiptare dhe shqipja ishte gjuha e domosdoshme e komunikimit në ambiente dykomunitare dhe jo njëkomunitare e familjare. Zona të tilla shkencërisht quhen zona gri.

Fenomeni i dygjuhësisë me elementë gjuhësor greqisht si të mbivendosur dhe shqip si varietete të ulëta ose si dygjuhësi tekniko-ekonomike, e ndikuar nga marrëdhënjet ekonomiko-tregëtare me Greqinë e paraluftës, egzistonte në një rajon gjeografik me të gjerë dhe në shtresa të lidhura më këto marrëdhënie.

Dygjuhësinë e hasim dhe në elementë të shpërndarë të M. E. Grek në të gjithë hapësirën shtetërore shqiptare, por sidomos në qytete të tilla më përparësi zhvillimi si Vlora, Durrësi, Tirana, Elbasani, etj.

Deri më 1990 realiteti i dygjuhësisë, si gjeopolitike, ashtu dhe tekniko-ekonomike po dhe dygjuhësisë familjare, është në raporte krejt të ndryshuar. Faktori politiko-ideologjik zëvendësoi çdo formë të lirë dygjuhësie dhe veproi për konsolidimin e vet.

Në zonat me popullsi homogjene varietetet e ulta, ose elementi i gjuhës amtare ishte i reduktuar në fjalorin e gjuhës së redomtë, ndërsa varietetet e larta ose gjuha zyrtare janë zotëruese. Vetëm moshat e treta ruajtën akoma raporte të kundërta por që gjuha e tyre prap nuk i korrespondonte zhvillimëve ekonomiko-sociale të kohës dhe kjo kategori zë peshën më të vogël në fondin aktiv të shoqërisë. I njëjti vlerësim mund të bëhet edhe për kategorinë e femrës të moshës së dytë brenda zonave me popullsi homogjene.

Kemi gjithashtu një shifer shumë herë më të rritur mbartësish të dygjuhësisë të difuzuar në shoqërinë shqiptare ku elementi i gjuhës amtare shpesh kishte thjeshtë vlera formale ose rudimentare. Nga kjo periudhë u trashëguar një numër shumë të madh martesash të kryqëzuara por me një dygjuhësi shpesh fiktive ose inegzistente.

Kjo situatë u kristalizua sidomos pas vitëve '70 kur kemi një ristrukturim të jetës ekonomiko shoqërore të fshatit me krijimin e formave të reja të koop. Bujqësore duke zëvendësuar format tradicionale të prodhimit me forma të reja të prodhimit intensiv.

Lidhet me hapjen e shkollave bujqësore po në gjuhën shqipe në fshat dhe me elektrifikimin ku mjetët e informacionit fitojnë një terren shumë më të madhë deri brenda në familje por që janë në gjuhë zyrtare.

Vitet '70 përcaktojnë dhe fazën e ndërrimit me dhunë të emrave të njëzëzve, të fshatrave apo dhe toponimeve të tjera ose i përdorimit të tyre vetëm në gjuhën zyrtare.

Pra evidentohen dy faktorë që çojnë në ndryshimin e raportëve të drejta për dygjuhësinë. I pari lidhet me zhvillimet në fushën ekonomiko-shoqërore, që pasqyroheshin vetëm në gjuhën zyrtare dhe i dyti ishte veprimi i faktorit ideopolitik. Ky faktor nga njëra anë e përdorte gjuhën (amtare) si mjet për të përçuar ideologjinë (dhe për ta bërë atë të qëndrueshme tek anëtarët e minoritetit etnik grek i hiqte çdo kontakt me traditën si kulturore ashtu kombëtare) dhe nga ana tjetër mbivendoste dhunshëm gjuhën zyrtare, tek mbartësit e një gjuhe amtare tepër të kufizuar,.

Për të gjitha këto shkaqe dygjuhësia tek elementë të tjerë shqiptar nuk mund të egzistonte më. Por u evidentua fenomeni i dygjuhësisë së elementit shqiptar në ato raste kur kemi një difuzion të tij në popullsinë homogjene të M.E. Grek, por që nuk përbën një komunitet të gjerë, të pranueshëm dhe të qëndrueshëm.

Shkaqet që çuan në ndryshimin e këtyre raportëve

Së pari politika izoluese e ndjekur nga shteti komunist dhe shpallja në këtë kontekst armik të Shqipërisë Greqinë, shtetin am të anëtarëve të Minoritetit Grek, ndërprerjen e të gjitha kanaleve komunikuese me shtetin am dhe shkatërrimi i gjithë literaturës së trashëguar në gjuhën amtare si dhe përndjekja e të gjithë atyre kuadrove që kishin studiuar në Greqi. përcillte tek kjo popullsi ngarkesa negative dhe boshllëq të theksuara në ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit kulturor e gjuhësor.

Se dyti, në menyrë të drejtpërdrejt, pavarësisht nga thellësia në kohë, nxitej nga shteti diferencimi i mësimi të dy gjuhëve në favor të theksuar të gjuhës zyrtare. (më 1947 shqipja mësohej në ciklin e lartë të shtatëvjeçarës si gjuhë e huaj. Më 1990 gjuha greke mësohej në shkollë si gjuhë e huaj)

Se treti Të gjitha format e zhvillimit të atij sistemi, ekonomi, kulturë, arsim depertonin në veprimtarinë e përgjithshme dhe të përditshme të Minoritetit etnik grek, vetem me gjuhën zyrtare. Tradita kulturore përçohej në masën 70 me 30 % në favor të gjuhës zyrtare. Mjetët propagandistike me aq peshë në jetën civile të atëhershme zhvilloheshin pothuaj terësisht në gjuhën zyrtare. Po ashtu në gjuhën zyrtare zhvilloheshin të gjitha marrëdhënjet me shtetin.

Po ashtu vlerat kulturore me trashëgimtarë autentikë komunitetin e minoritetit etnik grek në Shqipëri, ndëronin me porosi të partisë trashëgimtarin dhe krijuesin, gjë që vazhdon të ndodh edhe sot, dhe më të njejta porosi krijoheshin variante të historisë së origjinës së tyre etnike në shërbim të politikës dhe ideologjisë komuniste, gjë që krijonte asfiksi dhe konfliktualitet socila të pashprehur.

Se katërti, nevojat për arsimim të mëtejshëm - deri universitar, për punë më të preferuar, për karrierë, etj lidheshin jo thjesht me nevojën e mësimit të gjuhës shqipe, por ishte krijuar klima se mund të arriheshin duke mohuar, në formën e harrësës identitetin, ose anët e tij më identifikuese si gjuhën amtare.

PASOJAT

a. Përjetimi i një konflikti të brendshëm në statusin e tij dygjuhësor

Gjuha amtare, edhe në zonat me popullsi kombakte të etnisë greke tkurrej në fjalorin e gjuhës së rendomtë. Ajo pësoi deformime në përdorim dhe filloi të ndiqte një proces të vetin idiomatik zhvillimi, nën ndikimin e imponuar të gjuhës shqipe. Këtë ndikim e hasim më shumë në leksikologji por edhe në fonetikë, morfologji e sintaksë.

Me qindra fjalë që lidheshin me strukturat e reja të organizimit të jetësës dhe të punës socialiste hynin në arsenalin e gjuhës së përditshme të M.E.Grek herë të plota, herë duke u shtuar prapashitesa apo mbaresa të greqishtës. Kjo ndodhte se kanalet analoge të përdorimit të të njëjtave terma në Greqi ishin të bllokua. Madje dhe fjalë që shqipja i huazonte nga greqishtja si psh hibrid - Υβρίδιο, futeshin në fjalorin e ditës nga shqipja.

Ndryshimi i pozicionit të theksit nën ndikimin e shqipës ishte një fenomen i zakonshëm. P.sh mbiemri që sot edhe në greqisht është **Kíkína** është ndikim nga shqipja se në greqisht theksi është në rrokjën e tretë nga fundi dhe **k**-ja nën ndikimin e **i**-së shqiptohet (**q**), **Qíqinas – Kíkivaz**.

Humbja e s-së fundore tek emrat e përveçëm të gjinisë mashkullore, (p.sh Panajot Barka për Panajotis Barkas), ishte po ashtu një ndikim që ruhet edhe sot nga shqipja. Përdorimi i folljës shtrihem dhe shtrij etj ku mënyrës veprare në greqisht iu imponua menyra pësore e shqipës, etj.

Një ndikim i tillë çonte shpesh në gjymtimin e mëndimit dhe në cungimin e shprehjës. Madje duhet thenë se aq i madh ishte ndikimi i shqipës sa të gjitha kategoritë e njërëzve edhe kur donin të flisnin greqisht mendonin shqip. Kjo gjendje çonte në përjetimin e pashprehur të një konflikti të brendshëm gjuhësor.

Po ashtu nevoja për të siguruar mbijetësën i bënte ata të pranonin imponimin që u bëhej nga shteti totalitar drejt ruajtës së trajtave formale etnike sa për konsum propangandistik nga njëra anë dhe ideologjisë komuniste të krijimit të njëriut të ri hibrit komunist, pa fe, pa tradita, pa identitet, nga ana tjetër.

Ky fenomen, i imponimit apo dhe i vetimponimit të gjuhës zyrtare u zhvillua më dukshëm në të gjitha rastet, në mënyrë masive apo individuale jasht zonave me popullsi kombakte të etnisë greke, akoma edhe në familje me martesë të kryqëzuara. Në këtë kuadër dhe ndikimi reciprok në krijimin e një kulture dygjuhësore pozitive e kaloi masën duke u kthyer në faktor negativ.

Pra në kushtet e nevojës formale të ruajtës së identitetit etnik dhe të imponimit zyrtar zhvillohej klima e autonçensurës, deri në atë shkallë sa që anëtarët e Minoritetit Etnik Grek në Shqipëri, pranonin të thirreshin thjesht minoritarë. Përdorimi i emrit grek ishte sinonim i fjalës armik, ose përbente fyerje, madje dhe objekt i veprimit të kodit penal. U kultivua kështu pra një status i veçantë identiteti gjuhësor minoritari në vend të identitetit Etnik Grek.

Kjo gjendje krijonte trajta të pashprehura të konfliktit me strukturat politike, reagimin e të cilit e konstatuam pas 1991.

Vitet 1191 e në vijim

Kemi serish një ndryshim të raportëve në përbërësit e dygjuhësisë që përcaktohet nga

a.-rifitimi i komunikimit me kombin am,

b.- ndryshimi i qëndrimit politik ndaj anëtarëve të M. E. Grek nga politika zyrtare me tendencë drejt standartëve ndërkombëtare dhe

c.- ndryshimi po ashtu i raportit të marrëdhënjëve ekonomike shoqërore e kulturore.

Në këto kushte në Minoritetin Etnik Grek në Shqipëri, kemi një ekulibër të ri gjuhësor.

Egziston një brez të ri tek i cili përdorimi i gjuhës amtare është përfekte dhe shumë autoritare ndaj gjuhës zyrtare. Kemi një brez të mesëm i cili në rast se nuk ka zhvilluar kontakte të ngushta me shtetin am dhe ka ruajtur kontaktet tradicionale me shoqërinë shqiptare, gjuha amtare është inferiore ose në pozita të barabarta ndaj gjuhës zyrtare, dhe një brez të tretë që i përket moshës së tretë ku gjuha amtare është zotëruese.

Ndryshimi i raportit të elementeve të dygjuhësisë, në favor të gjuhës amtare greke kemi edhe në familje me martesë të kryqëzuar.

Gjithashtu raportet e reja ekonomike dhe i lidhjeve të shumfishta shoqërore e kulturore me Greqinë, risollën si domosdoshmeri dygjuhësinë në ambjent më të gjerë në formën e dygjuhësisë tekniko-ekonomike, me një shtrirje më të gjerë si dygjuhësi emigrantësh përtej kufirit nga njëra anë dhe dygjuhësi e pastër tekniko-ekonomike këtej kufirit dhe shtrirje deri në veriun e Jugut të vendit.

Mëgjithatë egziston edhe një “konflikt” i ri. Ai midis mentalitetit të trashëguar komunist sipas të cilit Minoritetit Etnik Grek i kishte të gjitha të drejtat dhe ronte i diferencuar nga pjesa tjetër e popullsisë, pra duket se zuri vend mirë propaganda komuniste deri në ditët tona, dhe i përprjekjeve për të rivenë të vertetën historike në vend.

Bibliografi

Gj. Shkurtaj, “Sociolinguistika”, Shblu, Tiranë 1999.

V. Bici, “Çeshje të dygjuhësisë në shkollat e pakicave”, Tiranë 2001.

A. Πασχάλης, «Τα μεταπολεμικά αναγνωστικά της Ελληνικής Μειονότητας της Αλβανίας», Αθήνα 1998.

Π. Βακαλόπουλος, «Επιγραφικά Σύμμεικτα από την Αλβανία», Ιωάννινα 1994.

R. Schwartyenberg, “Politika Sociologjike”, Athinë 1984.

R. Memushaj, “Vështrim mbi dygjuhësinë në Shqipëri”, stud. Albanol., 4, 1997.

Panajot Barka

2) Revista periodike “Kerkime Universitare” Universiteti i Gjirokastrës, nr. 9, 2004

“Polifonia tre-katërzërëshe tregues i një identiteti kulturor multi-etnik e multigjuhësor”

The purpose of this article is to underline the idea of the polyphonic song terca-tetraphonic as a cultural phenomenon characteristic of the whole region of Epir, as a product of reality reckoned in centuries from the territorial and administrative point of view and as a result of a common cultural substratum consequently its interpretation can be encountered in three languages: Albanian, Greek and Rumanian. The starting point of polyphony in the course of time should be sought at least before the Byzantine Period and can be identified with the Doric style of the ancient Greeks. Today's form of polyphony is the result of the development of this common musical substratum in the region of Epir, and of other impacts, why not even cultivated and specialized.

We are speaking about impacts from the polyphony of hymnology of the Catholic Church. This process was realized as a result of the influence of Venetia from the end of XIV century and the beginning of XV century up to XVIII century on the western coast of Epir and particularly in the region of Himara.

So Himara like Parga situated further in the south constituted the cross-road of the commercial and human transport from and to the west due their location, but not much to their relations with Venetia. All these factors made it possible for the polyphonic way of interpretation of the folk-song to be spread to other vast regions as well.

All these developments made it possible for Himara to be converted into the mother land of the polyphony of this genre at the borders of Epir which were defined by the Romans as the Old Epir.

It is a fact that the communist system without any official or public directive used the argument of the polyphonic song as the means to show the cultural and ethnic borders to the south of Albania.

Kënga polifonike vokale apo e shoqëruar me vegla muzikore ka një larmi dhe shtrirje gjeografike shumë më të gjerë se treva ku haset polifonia jonë tre - katërzërëshe. Mëgjithatë, është polifonia tre-katërzërëshe ajo që vazhdon edhe sot e kësaj dite të terheq vëmendjen e studiuesve. Kjo ndodh fal larmisë melodike në interpretim, larmisë gjuhësore dhe vitalitetit në funksion të kulturës muzikore popullore.

Në këtë plan, pavarësisht nga konkluzionet e ndryshme lidhur me gjenezën, ka pak a shumë një unitet mendimi se polifonia tre-katër zërëshe ka një shtrirje gjeografike në të gjithë zonën e Epirit. Si e tillë do të thoshim se përbën ekstraktin më substancial shprehës të veçorisë dalluese të kulturës së kësaj treve dhe paraqet vlera estetike të papërseritshme që i siguruan Epirit, si në çdo fushë tjetër, qëndrueshmëri e mbijetesë.

Kjo nuk lidhet thjesht me faktin se ishte produkt i një realiteti të njëhsuar në shekuj nga pikëpamja teritoriale administrative. Por më shumë ishte rezultat i një nënshtrati të përbashkët kulturor. Mbi të ngrihej një realitet bietnik - multikulturor e multigjuhësor, i cili përbënte në çdo kohë faktorin që i siguronte Epirit avantazhin për t'u paraprirë zhvillimeve që do të pasonin në rajonin më të gjerë në të gjitha fushat. I siguronte në radhë të parë pavarësinë dhe qëndrueshmërinë e kulturës së vet me emblemën dalluese në muzikë: polifoninë.

Si e tillë polifonia nuk njihet kufij shtetërorë. Si fenomen shfaq një ndryshueshmëri relative në raport me hapësirën, kohën, gjuhën, etninë dhe në këtë kuadër edhe në formën e interpretimit, si polifoni dhe si realitet për zhvillime të tjera të traditës muzikore.

Një sprovë për gjenezën e polifonisë tre-katërzërëshe

Njëri i zakonshëm, në zonën e Epirit, kur thotë “polifoni”, nuk ka parasysh sistemin muzikor që u zhvillua në Evropë gjatë periudhës së Rilindjes dhe të Barokut mbi bazën e “melodisë Gregoriane” të shekullit XII –XIII. Ai ka parasysh traditën e tij muzikore në shekuj, si një veçori dalluese e trevës së vet.

Kjo ka detyruar shumë studiues të kërkojnë gjenezën e pikënisjes së këtij fenomeni, (monogjenzë-poligjenzë), shtirrjen në kohë dhe hapësirë, raportet e ndryshueshme në marrëdhëniet midis homofonisë dhe polifonisë etj.

Nga pikëpamja e shtrirjes gjeografike, po të nisemi nga unikaliteti, do të vemë re se polifonia katërzërëshe ka epiqendrën në pjesën veriperëndimore të pjesës qendrore të trevës së polifonisë nën Vjosë, të njohur në kohën e romakëve si Epiri i Vjetër. Që këtej vihet re një hapje rrethore e këtij lloji (polifonie) që shkon nga veriu, (në një largësi të vogël), verilindja e lindja e deri tek juglindja e po kësaj treve. Sa më shumë largohemi nga kjo vatër, aq më shumë kemi humbjen e “virgjërisë” polifonike tre-katërzërëshe. Paralelisht kemi shfaqjen e polifonisë dyzërëshe, homofonisë, heterofonisë apo monofonisë, të shoqëruar me saze apo dhe të mënyrave të ndërmjetme interpretimi, apo bashkëjetesën e tyre për të arritur në ekstremin tjetër, tek homofonia si mënyrë të vetme interpretimi. Ky fenomen kuptohet se nuk ka një linearitet njëtrajtshmërie, as është i dhënë një herë e përgjithmonë e as merr parasysh kufijtë shtetërorë.

Gjithashtu, fenomeni i polifonisë tre – katërzërëshe, ashtu si polifonia dyzërëshe e jugut të Vjosës, bazohet mbi tri gjuhë: shqip, greqisht dhe vllahisht.

Realiteti i ekzistencës së një bërthame të qëndrueshme polifonie që zbehet më largimin prej saj, është i pranishëm edhe sot. Ai na çon në përfundimin se, përsa i përket gjenezës së polifonisë së sotme tre-katërzërëshe, kemi të bëjmë me fenomenin e monogjenzës, domëthenë të lindjes së fenomenit në një vatër të vetme dhe përhapjes së tij në një trevë më të gjerë me karakteristika kulturore të përngjashme, ose me një nënshtrat të përbashkët kulturor.

Përsa i përket kohës së “lindjes” së polifonisë, pothuajse të gjithë studiuesit pranojnë se polifonia i ka rrënjët “në ekzistencën e një nënshtrati të lashtë e të

përbashkët muzikor, që i përket periudhës para kristalizimit të dy grupimeve apo kategorive muzikore (polifonisë dyzërëshe dhe tri-katërzërëshe, shenimi ynë)”¹.

Ismail Kadare, në vitet '80, e konsideronte polifoninë një mënyrë të lashtë interpretimi muzikor, si një zhvillim me pikënisje korin e Greqisë së lashtë. Ruajtja dhe zhvillimi i fenomenit të polifonisë në jug të Shqipërisë lidhet, sipas Kadaresë, me “kontaktet e popullsisë së këtushme me kulturën klasike greke”. Duke marrë si argument “ison”, Kadareja thotë se “Kënga polifonike është akoma më e vjetër nga kori i lashtë”². Konservimi i kësaj mënyre zhvillimi lidhet, sipas Kadaresë, me mënyrën e mbyllur të jetësës së Shqiptarëve, në male, që solli dhe zhvillimin idioritmik të korit të lashtë në këngë polifonike.

(Përsa i përket konkluzionit të fundit të Kadaresë, në të njëjtin përfundim arrin edhe K. Lolis. Dua të them gjithashtu se përvoja ime arrin në të njëjtin përfundim. Krahinat malore si e Pogonit në Gjirokastrë, e Gravës, Dhrovjani etj, në Sarandë e Delvinë, si dhe fshatra të krahinave të tjera, qoftë edhe fushore në këto dy rrethe, të cilat nuk kishin kontakte intensive me kultura muzikore të tjera, kanë me të zhvilluar polifoninë.)

Studiuesi francez i këngës së Epirit dhe i polifonisë, Samuel Baud Bovy, duke iu referuar studiuesit grek të po këtij objekti, Spiro Peristerit, (1958), mbështet pikëpamjen e këtij të fundit se “... isoja dhe lëvizja melodike e zërit të atij që e kthen në pjesën tonike dhe hipotonike janë elemente që gjenden edhe në muzikën kishtarë bizantine.”³

Kostas Lolis thotë se kënga polifonike “është më e vjetër se kënga në Bizant”. Pikëpamjen e tij e mbështet tek karakteri retorik, që do të thotë se melodia në këngën polifonike më shumë i ngjan zërit të njëriut, se sa melodisë së mirëfilltë muzikore dhe zhvillohet mbi bazën e bashkimeve në forma të ndryshme të shkallës pentatonike animitone. Ai thotë se zhvillimi muzikor dhe artistik i këngës polifonike është realizuar në një kuadër kohor shumë të gjatë... dhe i përket një zhvillimi artistik të homofonisë drejt polifonisë dyzërëshe, ose dyshe.

Lidhur me këtë konkluzion të muzikologut tonë K.Lolis, etnomuzikologu grek Llabros Lavas thotë se “Kjo shkallë muzikore, siç kanë provuar studimet e fundit muzikore, identifikohet me stilin dorik të grekëve të lashtë, “me harmoninë e mirëfilltë greke”⁴

Muzikologu hollandez Jaap Kunst, të cilit i referohet Llabros Lavas⁵, e lidh polifoninë e Epirit me Indonezinë e largët. Ai gjen analogji jo vetëm në strukturën dhe emërtimet e këngëtarëve, por edhe në motivet që stolisin kostumet e tyre.

(Kjo tezë na risjell në kujtesë hipotezën e njohur të origjinës së përbashkët të grekëve dhe shqiptarëve të ardhur në këto treva me diferencë kohore nga 12-15 shekuj i pari nga i dyti, duke filluar nga shekulli i tridhjetë para Krishtit)

Duke marrë në konsideratë këto e konkluzione të tjera, si dhe duke u nisur nga realiteti i tanishëm, do të thoshim se forma e sotme e polifonisë, si drejtim muzikor i traditës autoktone është rezultat i zhvillimit të nënshtratit të përbashkët muzikor të trevës së Epirit dhe i ndikimeve të tjera, pse jo të kultivuara e të specializuara.

¹ Kruta, B. Polifonia dyzërëshe e Shqipërisë jugore, Tiranë 1989, fq. 10.

² Kadare, I. Autobiografia e popullit në vargje, Tiranë, 1980, fq. 8.

³ Baud Bovy, S. Sprovë për këngën popullore greke, 1984, fq. 50.

⁴ Lavas, L. Apeiros, botim i qëndrës së Thesprotisë për kulturën dhe ambientin, numri 1, Janinë 1988, fq. 19.

⁵ Po aty, fq. 19.

Fjala është për ndikime nga polifonia e himnografisë së kishës katolike. Ky proces u realizua falë ndikimit të Venedikut, fundi i shek XIV- fillim i shek XV deri në shekullin XVIII, në brigjet perendimore të Epirit, veçanërisht në krahinën e Himarës. Prania e Venedikut, për një periudhë kaq të gjatë në Himarë, u shoqërua me përpjekje historikisht të njohura për përhapjen e katolicizmit dhe të kulturës venedikase në këtë rajon. Po ashtu është e ditur se polifonia e himnografisë kishtare katolike kishte përparësi të tilla që bënë edhe Careshën Ekaterini të Rusisë ta pëlqente dhe të kërkonte aplikimin e saj në kishën ruse.

Këto zhvillime, pra, nuk mund të mos linin gjurmë në kulturën e polifonisë himariote. Aq më tepër kur pranohet pothuaj nga të gjithë ekzistenca që në lashtësi të një polifonie dyshe me apo pa iso në trevën më të gjerë të Epirit, pra, edhe në Himarë, ashtu siç pranohet ekzistenca e një “iso-je” të himnografisë kishtare bizantine.

Pikërisht, ekzistenca e një tradite të gjatë dhe relativisht të fuqishme polifonie, si dhe fakti që në këtë rajon (Himarë e më gjerë), për shkak të situatave, të luftërave të përhershme me Turqinë, bëri që polifonia të mos kishte këtu të njëjtin zhvillim si në Perendim. Në mënjanimin e një zhvillimi të njësuar me Perendimin është e sigurt që ndikoi edhe mungesa e veglave tradicionale muzikore.

(Fakti që shumë kohë më vonë, fund i shek XIX deri në ditët tona, polifonia tradicionale e zhvilluar dhe me qëndrueshmëri të kristalizuar, pranoi shoqërimin e veglave muzikore me gjithë pasojat në strukturën e polifonisë vokale, na lejon të themi se kjo mungesë veglash muzikore shekuj më parë bëri që ndikimi venecian të ketë sjellë zhvillimin në formën që ne njohim edhe sot të polifonisë së hershme tradicionale të Epirit.)

Samuel Baud – Bovy na thotë gjithashtu se “polifonia në Eptanisa është e ndryshme (ishuj në Jug të Korfuzit ku venediku sundoi për tre shekuj,- shen. i aut). Primi, tenori, thotë gjysmën e vargut. Në vijim atë e shoqërojnë një i dytë -sekondo dhe një i tretë – terc dhe një apo dy bas. Këtu nuk dëgjon zëra të dyta dhe të katërta si Dropull, por kore Evropiane, - na thotë Bovy ⁶.

Gjithashtu, nuk mund të injorohet fakti, serish i vertetuar historikisht, se, Himara me ndihmën e Venedikut ruajti një status autonomie përballë Turqisë. Si rezultat, krahina u shndërrua në një strehë lirie për të gjithë ata që në viset e tyre nuk e duronin zgjedhën e Turqisë. (Kjo shpjegon realitetin e sotëm që Himara nuk ka një homogenitet etnik). Po ashtu Himara, si dhe Parga më në Jug, për shkak të vendndodhjes, por më shumë për shkak të marrëdhënieve me Venedikun, përbënin udhëkryqin e lëvizjeve tregtare e njërëzore nga e në drejtim të Perëndimit. Pra, flasim për një trevë që favorizonte zhvillimin ndryshe në funksion të një konvencionalizmi të ri kulturor e etnik.

Ky këndvështrim na lejon të themi se Himara, me një kuptim gjeografik më të gjerë dhe nën ndikimin e traditës polifonike instrumentale venedikase ose përendimore, shërbeu si bazë për kultivimin dhe zhvillimin e traditës popullore muzikore ekzistuese, në polifoninë e sotme tri dhe katër zëreshe. Që këtë, për shkak të pozicionit favorizues në lidhje me pushtimin turk, por edhe të superioritetit tregtar e të marrëdhënieve më të gjera me Perendimin, kjo mënyrë polifonike e interpretimit të këngës popullore u përhap edhe në krahina më të gjera.

Pra, këto zhvillime bënë të mundur kthimin e Himarës në një trevë mëmë për polifoninë e këtij lloji në kufijtë e Epirit, të përcaktuar nga romakët si Epiri i Vjetër. Në vijim, çdo krahinë, në bazë të kombinimeve të ndryshme të pentatonisë, shtonte

⁶ Baud Bovy, S. Sprovë për këngën popullore greke, 1984, fq. 51.

dhe hiqte elementet e veta. (Pikërisht, ky gërshetim shpjegon edhe larminë tipologjike të polifonisë në një zonë më të gjerë.

Një argumentim i tillë nuk na lëjon të flasim për një fenomen të mirëfilltë monogjeneze. (Siç thamë, ekzistonte një traditë polifonie vokale dhe mbi këtë bazë kemi një zhvillim të ri nën një ndikim po të fuqishëm muzikor.)

Një argument më shumë në mbështetje të këtij konkluzioni, të Himarës në rolin e mëmës për polifoninë katërzërëshe, na sjell edhe fenomeni në zhvillim. Fjala është për zbëhjen, tërheqjen e mënyrës polifonike të interpretimit të shumë këngëve në krahina të tjera edhe përreth Himarës. Kjo tërheqje ndodhi për shkak të presionit të orkestrinave popullore të udhëhequra nga klarineta drejt interpretimeve solo apo të një repertori polifonik të veçantë, por të shoqëruar me saze.

Mjafton të ecesh një ditë në trotuarët e shetitores së lagjes "18 shtatori" në Gjirokastrë dhe menjëherë do të vesh re se nga tezgat e shitësve ambulantë të kasetave e të disqeve me këngë popullore, vijnë meloditë e sazeve që shoqërojnë pothuaj gjithë repertorin e këngëve që dikur interpretoheshin me polifoninë karakteristike "labe". Këto këngë të sh polifonike dëgjohen tani me melodi të këngëve të tjera të shoqëruara me saze në pjesën greke të Epirit. Dikur, edhe ato këndoheshin me polifoninë vokale tre -katërzërëshe. Ndodh natyrshëm fenomeni i njohur në folklor. Melodia e një kënge, edhe pse të në etnie tjetër, përdoret për të interpretuar një këngë tjetër. Në rastin tonë, meloditë e këngëve me saze në gjuhën greke "huazohen" për të interpretuar një këngë në gjuhën shqipe, duke shmangur interpretimin e tyre me polifoninë katërzërëshe.

Në Himarë nuk vihet re një fenomen i tillë. Madje, edhe këngët e reja të karakterit, do të thoshnim komercial, të serviuara nën shoqërinë e sazeve popullore, këtu interpretohen me polifoninë karakteristike himariote.

Nga ana tjetër, në pjesën greke të Epirit, gjithnjë e më shumë, shtohen kërkesat për këngë të interpretuara nga Laver Bariu, ku sazet shoqërojnë një tipologji të veçantë këngësh polifonike, (ato të Permetit) të ngjashme me ato të Konicës. Të shtuara janë këtu edhe kërkesat për këngë të mirëfillta polifonike, të kënduara greqisht apo shqip. Këtu, në pjesën greke të Epirit, vihet re gjithashtu hapur tendenca e shtimit të një polifonie të veçantë, ajo e interpretimit të këngëve polifonike të shoqëruara me saze.

Besoj se do të mjaftonte edhe ky konstatim për të pohuar edhe një herë njëtrajtshmërinë e një nënshtrati të përbashkët kulturor i cili, pavarësisht nga gjuha apo etnia, lejon pa paragjykime huazime e antihuazime, ndryshime të mënyrës së të kënduarit, dëshirën për të krijuar vlera

Po ashtu, kam mendimin se në larminë tipologjike të këngës polifonike duhet marrë shumë në konsideratë marrëdhëniet e polifonisë me himnografinë kishtarë bizantine. Argumentet që mund të sjellim, përveç atyre të specializuara e të përmenduara më lart, është fakti që kisha ortodokse, si vijimësi organizimi i periudhës bizantine, -të një perendorie më jetëgjatë me pushtet të dyfishtë dhe të barabartë:-politik dhe fetar,- në jetën shoqërore, përbënte insticionin qëndror kulturor e organizativ të shoqërisë së mbyllur tradicionale. Si e tillë feja ortodokse ka një ndikim dhe pjesëmarrje të jashtëzakonshme në doket, zakonet dhe konstitucionin shpirtëror, vëçanërisht të Epirit. Themi të Epirit për arsye se në periudhën bizantine Epiri dhe Maqedonia përbënin dy krahina nga më të rëndësishme të provincës së Perandorisë së Bizantit me zhvillim kulturor të vetin të marrë parasysh nga Konstandinopoja, por edhe me kontakte me Perendimin. Ky rol u duk vëçanërisht qartë gjatë kryqezatave, përballimit të sulmeve nga veriu -të sllavëve të St.Dushanit dhe të fiseve shqiptare të ardhura nga veriu i sotëm i Shqipërisë, italianëve etj,- dhe

sidomos gjatë periudhës së pushtimit otoman ku Epiri i takoi fati i rezistencës ndaj pushtuesit. Kisha u bë strumbullari i qëndresës me armë dhe me dije, fillimisht për të penguar përhapjen e myslymanizmit dhe me vonë në përpunimin e ideologjive të reja kombëtare për popujt që e baninin atë. Në këtë aspekt fakt është që në jetën shpirtërore si të myslymanëve dhe të krishterëve të kësaj treve doket dhe zakonet kanë një ngjashmeri të tillë që lëjon fare lehtë për të provuar nënshtratin e përbashkët dhe të paparagjykuar nga bartësit e tij, qofshin myslymanë apo të krishterë, shqiptarë apo grek.

Atëherë, përderisa polifonia përbën emblemën e qëndrueshme, dalluese, diakronike të kulturës së Epirit, -që para krishtit, para e pas Bizantit, - dhe kjo cilësi derivohet, ose i dedikohet aftësisë së saj, polifonisë, për të përvetësuar në mënyrë krijuese dhe korresponduese me çdo plan kohor dhe pa cenuar identitetin e vet, atëhere , pra, nuk mund të mos pranohet që kënga polifonike nuk pati marrëdhënje e komunikim reciprok me himnografinë kishtarë bizantine-ortodokse. Ashtu siç pranuan edhe ndikimin nga kultura polifonike venedikase për arsye se polifonia vokale autoktone gjeti diçka të përbashkët me polifoninë perendimore. Këtu shtojmë faktin se koncepti i provincës për Epirin dhe i mëvetësisë së saj kulturore na çon në konkluzionin se ajo, pavarësisht nga rigoroziteti konservator në respektimin e traditës fetare edhe në himnografinë, në kontakt me polifoninë autoktone, bëhej vetkrijuese (muzika e liturgjisë kishtarë). Kjo për faktin se bartësit më të talentuar të traditës muzikore vendase apo autoktone .-polifonisë, - bëheshin profetërinj, psalltë etj. Lë të mos harrojmë se Epiri ka një kontribut të madhë në aspektin e burimeve njërezore të kultivuara në të gjitha nivelet dhe gjeografinë e kishës bizantino-ortodokse. Fakt është që himnografi i fundit me famë ekumenike i muzikës kishtarë bizantine ishte nga Dhrovjani i Delvinës, i cili për meritat e veta u nderua si nga Patriarkana edhe nga Akademia e Shlencave të Greqisë. Vdiq më 1993.

Pikërisht ky kendveshtrim na ndihmon edhe për një klasifikim sa më objektiv të këngës polifonike. Nënshtrati i përbashkët se bashku me huadheniet dhe huamarrjet me të gjitha format muzikore që i përshtateshin zhvillimit të identitetit të vet pa i ndryshuar thelbin, përfshi edhe bizantine e polifoninë e kultivuar perendimore, krijuan profilin e polifonisë që kemi sot. Ndarrja fetare në myslymanë dhe të krishterë pas pushtimit otoman bëri që ajo pjesë e bartësve të polifonisë që vijuan besimin e tyre fetar të ruajnë një mënyrë më të butë, më të shtruar interpretimi të polifonisë. Ata që u larguan nga ky besim, pra edhe nga ndikimi i drejtpërdrejtë i himnografisë kishtarë bizantine dhe marrëdhënieve me të, sollën zhvillime të reja, të cilësuar si “më burrërore” të polifonisë. Këtë dallim në mënyrë të specializuar e vë re edhe Kosta Lloli. Kështu mund të shpjegohet edhe fakti që pse sistemi komunist duke rimarrë parimin e dallimeve etnike sipas përkatësisë fetare, identifikoi laberinë si simbol të shqiptarizmit në jug dhe nga pikëpamja kulturore identifikoi polifoninë me këngën labe).

Kënga polifonike dhe përdorimi abuziv si tregues e identitetit etnik dhe me funksion ideologjik.

Fakt është se sistemi komunist, pa direktiva zyrtare e publike, e përdori argumentin e këngës polifonike si një mjet për të provuar kufij kulturorë etnikë në jug të Shqipërisë. Këto qëndrime mbarthen shpesh edhe sot dhe mendojmë se reflektojnë një background konkluzionesh abuzive të imponuara nga ideologjia komuniste. Dhe ashtu siç i theksuam, abuziviteti lidhet me hapësirën, gjuhën e etninë, por jo më kohën, d.m.th, me fillesat dhe ecurinë e këngës polifonike.

Në këto qëndrime pranohet si vijë ndarëse e polifonisë në veri vija natyrale e luginës së lumit Shkumbin. Në jug si vijë ndarëse caktohet konveconi politik i kufirit shtetëror. (Dhe aspak shtrirja hapësinore natyrale të polifonisë e cila i kapërcen kufijtë shtetërorë). Studiuesit e njohur të polifonisë, si B.Kruta, S. Shituni etj, arrijnë në konkluzionin se brenda kësaj treve, ajo, (polifonia), ndahet në dy njësi gjeografike : në atë që shtrihet midis lumenjve Shkumbin dhe Vjosë dhe tjetra në jug të lumit Vjosë, deri në kufijtë shtetërorë. E para njihet me emrin polifonia toske dhe e dyta: polifonia labe. Siç shihet, këto emërtime lidhen me dy krahina në Shqipëri, por edhe vetëm me gjuhën shqipe⁷, dhe që të gjithë e kuptojnë se i përgjigjen konditave politike të periudhës komuniste.

Siç e theksuan, pothuaj të gjithë studiuesit pranojnë se polifonia i ka rrënjët “në ekzistencën e një nënshtrati të lashtë e të përbashkët muzikor, që i përket periudhës para kristalizimit të dy llojeve të polifonisë dy dhe tre-katërzërëshe. “Sipas pikëpamjes së shumë studiuesve, - thekson K. Lolis, - të kënduarit në polifoni të llojit në fjalë është më i vjetër se ai bizantin.”⁸

Përsa i përket shtrirjes gjeografike, polifonia tre-katër zërëshe i përket gjithë Epirit. Kjo do të thotë se në jug i kapërcën kufijtë shtetërorë shqiptarë për të prekur kufijtë etnokulturorë jugor të Epirit. Siç e thamë ajo haset në shqip, greqisht e vllahisht që përbëjnë tri gjuhët identifikuese të kësaj treve.

Pra, sistemi komunist e përdori argumentin e këngës polifonike si një fakt për të provuar kufij kulturorë etnikë në jug të Shqipërisë. Për këtë arsye polifonia u identifikua fillimisht me polifoninë karakteristike tre-katër zërëshe, e cila shtrihet në Jug të Vjosës. Në vijimësi, kjo mënyrë interpretimi polifonik u indentifikua si këngë labe dhe krahina e Labërisë u njehsua me simbolin e shqiptarizmit në Jug.

Si një ideologji kulturore, ky koncept shkon edhe më tej. Dihet se edhe në Epir, gjatë periudhës së Perandorisë Otomane ideologjia e rum millet-it shërbeu si kriter për ndarjen etnike në bazë të përkatësisë së besimit fetar. Sistemi komunist, në kushtet ku ndryshueshmëria fetare ishte eliminuar me dhunë, po përdorte polifoninë dhe rrënjët e saj të lashta, si një element tregues dhe unifikues etnokulturor të origjinës shqiptare të trevës bartëse të polifonisë me prapavijë të theksuar, por të pashprehur myslimane.

Po të shikojmë me kujdes bibliografinë rreth folklorit të qytetit të Gjirokastrës, veçanërisht atë të dasmës, do të vemë re se pranohet fakti që këngët e ceremonialit të dasmës gjirokastrite pasqyrojnë ndikimin në mënyrë intensive të këngës së po këtij ceremoniali të Lunxherisë, Labërisë, Zagorisë, Dropullit etj që në përgjithësi është një këngë polifonike. Mirëpo ky pohim bëhet, pasi- nga njëra anë, “harrohet” fakti që si në qytetin e Gjirokastrës ashtu edhe në Lunxhëri apo Zagori e Dropull haset “dyzërëshi polifonik paraburdonal”⁹ (pa iso), nga ana tjetër, polifonia tre-katërzërëshe e krahinave të përmenduar është identifikuar si polifoni labe. Po ashtu, ndër marrëdhëniet e qytetit të Gjirokastrës me krahina për rreth, veçohen e fokusohen lidhjet me Labërinë, kur dihet se e verteta historike nuk është plotësisht kështu. Rrjedhimisht, ceremoniali i dasmës gjirokastrite njehsohet me këngët e ceremonialit lab. Në këtë kontekst këngët polifonike gjirokastrite që promovohen më me zell janë ato me afëri më të mëdha me këngën polifonike të krahinës së Labërisë.

Nga ana tjetër, mënyra e interpretimit në grup i këngëve polifonike me një harmoni e strukturë të brendshme organike e virtuozë, që garanton disiplina dhe forca

⁷ B.Kruta, Polifonia dyzërëshe e Shqipërisë jugore, Tiranë 1989, fq. 3-21.

⁸ Lolis, K. Qendra e Thesprotisë për kulturën dhe ambjentin, numri 1, Janinë 1988, fq. 30.

⁹ Kruta, B. Polifonia dyzërëshe e Shqipërisë jugore, Tiranë 1989, fq. 9.

imponuese e ligjesive të pashkruara të traditës popullore, i shkonte shumë përshtat ideologjisë komuniste të kultivimit të ndjenjës së kolektivitetit socialist.

Po ashtu, kënga polifonike, në kuadrin e mjeteve të folklorit, përbënte një mjet efektiv për të arritur mitizimin e figurës së udhëheqësit të Partisë. Dihet se folklori përdor mitizimin dhe himnizimin e heronjve dhe ngjarjeve që lidhen me koshiencën dhe kujtesën popullore, si mjete të përdorura për rezultate për atosugjestionimin dhe orientimin e sjelljes kolektive të popullit në të ardhmen. Por, polifonia me strukturën e veçantë muzikore dhe përfitimin estetik që rrjedh nga kontributi i secilit pjesëtar të kolektivit në grupin polifonik, siguron një përparësi në këtë drejtim. Aq më tepër, që vet udhëheqësi ishte nga treva e këngës polifonike.

Kënga polifonike dhe abuzimi me identitetin etnik në minoritetin grek në Shqipëri

Në këtë kuadër, ekzistencën e këngës polifonike edhe në minoritetin etnik grek, pavarësisht se nuk u pohua kurrë zyrtarisht, u përdor de facto si argument për të provuar pretendimin e njohur se ky minoritet i ardhur në këto troje si një shresë argatësh¹⁰, përvetësoi traditën kulturore vendase, atë të polifonisë labe.

Në favor të këtij konkluzioni flet fakti që, në të gjitha shfaqjet publike dhe zyrtare të karakterit popullor, minoriteti grek paraqitej medoemos edhe me këngë polifonike dhe përherë e më shumë rritej në mënyrë të detyruar për qindja e këngëve polifonike të kënduara në shqip.

Po ashtu, deri në fillim të viteve '80, në fonotekën e emisionit në gjuhën greke në radion shtetërore lokale të Gjirokastrës, ekzistonin, krahas valleve me saze, vetëm këngë polifonike të kënduara në shtrirje kohore disa vjeçare nga grupe të ndryshme të minoritetit grek, kryesisht nga rrethi i Gjirokastrës.

Për këtë flet edhe këmbëngulja fanatike e shtetit për të mos lejuar përhapjen e këngëve tradicionale të këtij minoriteti nën shoqërinë e sazeve. Një gjë e tillë trajtohej si element komunikues e njehsues me pjesën greke të Epirit. Këmbëngulja ishte e tillë sa që nuk merte parasysh as realitetin në vet minoritetin grek. (Këtu, këngët e shoqëruara me saze si pjesë e traditës muzikore të tij, por më shumë të shtuara nga presioni i ardhur nga pjesa greke e Epirit, ishin mbisunduese në të gjitha dasmat dhe gëzimet familjare e kolektive.)

Nën një presion të gjithanshëm u lejuan interpretimet e para të këngëve të shoqëruara me saze në forumet zyrtare folklorike dhe në minoritet. Këtë rol e mori përsipër fillimisht Ansambli i Dropullit të Poshtëm. Por ndryshe nga ajo që ndodhte në pjesën greke të Epirit dhe në realitetin e minoritetit etnik grek, ku këngët e përbashkëta, tradicionalisht polifonike, interpretoheshin në shoqërinë e sazeve, interpretimet e Ansambilit të Dropullit kultivonin në fakt një kulturë popullore socialiste (folklor socialist), me ritëm, melodi e timbër zëri që nuk kishte asnjë lidhje me realitetin folklorik në minoritet. Kujdes i veçantë tregojë që të mënjanohej çdo ndikim apo motiv melodik që kultivohej në Greqi.

Nuk kemi pse dyshojmë që interpretimi nën shoqërinë e sazeve të këngëve polifonike tradicionale në minoritet, përveç se siguronte epërsi për një pjesëmarrje masive e për t'u shprehur emocionalisht në grup, ishte njëkohësisht një reagim për të veçuar veten nga identifikimi "me realitetin e ri socialist" që përfitohej nga imponimi i polifonisë. Rrjedhimisht, braktisja e polifonisë, sidomos nga brezi i ri, kishte një

¹⁰ Akademia e Shkencave të RPS të Shqipërisë, Fjalori enciklopedik shqiptar, Tiranë 1985, fq. 211.

arsye më shumë, në fakt alogjike, që të ndodhte dhe të vazhdojë të ndodh, ose të konsiderohet e huaj për të.

Polifonia - fenomen i qëndrueshëm dhe i qënësishëm në Minoritetin Etnik Grek

Dihet që në korpusin e këngëve dhe të riteve të dasmës janë të pranishme të gjitha llojet e këngëve popullore që kanë stigmatizuar jetën e një populli a të një komuniteti në shekuj. Si e tillë dasma të jep mundësi studimi të fenomeneve kulturore, në aspektin diakronik, por edhe tendencat e zhvillimit dhe evolimit të tyre në formë të koncentruar. Nga ana tjetër, në to nuk mund të gjejmë huazime apo elemente të jashtme. Çdo gjë në ceremonialin e dasmës është pjesë organike e kulturës shpirtërore e materiale të grupit që e manifeston.

Duke u nisur nga ky këndvështrim, konstatojmë se polifonia tre-katërzërëshe ashtu si dyzërëshe, në komunitetin e minoritetit etnik grek në Shqipëri ka një prani të qënësishme, të qëndrueshme e me thellësi kohore të papërcaktuar dhe që përbën një karakteristikë të përbashkët me polifoninë në gjuhën shqipe dhe në të gjithë Epirin në përgjithësi.

Në këngët e ceremonialit të dasmës hasim në një bashkëjetesë natyrale me polifoninë në diskutim edhe mënyrat e tjera të kënduarit të njohura në këtë trevë. Madje, këto mënyra e kanë të përcaktuar momentin dhe kohën e interpretimit.

Momentet e tilla, si ai i ndarjes së nuses dhe i dhendrit nga familja e vet, përcjellja, bashkimi i nuses me dhendrin në shtëpinë e re etj., shoqërohen nga kënga polifonike tre-katërzërëshe. Kënga polifonike është mbisunduese edhe në një pjesë të këngëve të tavolinës. Por nuk mund të bëhet fjalë për këngë polifonike tre apo katër zërëshe, që të shoqërojnë vallet e kënduara.

Një tjetër gjë që duhet venë re është se këngët që shoqërojnë vallet nga pikëpamja tematike, kanë lidhje të shumëfishta motivesh me baladat e hershme, me këngët epike, ose këndohen fragmente nga vet ato.

Në këngët e tavolinës, shume këngë të natyrës shoqërore këndohen në të dy mënyrat. Por nuk hasim p.sh këngë kaçakësh të kënduara në mënyrë polifonike. Mirëpo, në këngët e përcjelljes së nuses për në kishë, gjejmë motive të këngëve akrite (epike) të kënduara në polifoni katërzërëshe. (ndoshta ka lidhje me faktin se dasmorët nga që duhej ta shoqëronin gjatë gjithë rrugës çiftin e ri me këngë, preferonin këngë të zgjatura në kohë. Nga ana tjetër kërkoheshin motive që nuk kishin lidhje të drejtpërdrejta me ndarjen e nuses nga shtëpia e prindërve që i ngjante një gjëme)

Në favor të konkluzionit se polifonia është karakteristikë e qëndrueshme dhe e qënësishme e minoritetit grek, apo e trevës që lidhet me të, flet fakti që këngë të tilla që përbëjnë monumente të papërsëritshme për identitetin muzikor e kulturor të minoritetit etnik grek në Shqipëri, si “Moj Dropullite” dhe “Në fushën e Dropullit”, janë kënduar dhe vazhdojnë të këndohen me mënyrë polifonike katërzërëshe. Kjo pavarësisht nga shkalla në rritje e presionit dhe e ndikimit të mënyrës së kënduar me saze.

Po ashtu, prania sot e një repertori polifonie në rritje, edhe në këngët e shoqëruara me saze, tregon se sa thellë dhe sa jetike është kënga polifonike për kulturën muzikore të minoritetit grek.

Pra, konkluzionet që mund “të tërheqim” janë më se të qarta. Këngët polifonike në këtë trevë nuk funksionuan në formën e ndikimit. Ato janë pjesë e

brendshme organike e kulturës së bartësve të tyre dhe përderisa kanë zënë një vend mbizotërues në ritualin e dasmës, atëherë shkojnë shumë thellë në kohë.

Referencë

- Akademia e Shkencave të RPS të Shqipërisë. Fjalori enciklopedik shqiptar, Tiranë 1985.
- Apeiros. Qendra e Thesprotisë për kulturën dhe ambjentin, numri 1. Janinë 1988.
- Barka, P. Folkloristika, tekst Univeristar, Tiranë 2003.
- Baud Bovy, S. Sprovë për këngën popullore greke, Athinë 1984.
- Gjokuataj, T. Lirika e dasmës tradicionale Gjirokastrite. Tiranë 1996.
- Kadare, I. Autobiografia e popullit në vargje, Tiranë. 1980.
- Kasoruh, N. Gjirokastra e festivalit, Tiranë 2000.
- Kruta, B. Polifonia dyzërëshe e Shqipërisë jugore. Tiranë 1989.
- Loli, K. Tradita muzikore e minoritetit etnik grek në Shqipëri. Selanik 1994. (referim në kongres)
- Panajoti, J. Raporti midis kolektivës dhe individualës në folklorin tonë bashkëkohor, punim dijetaric. Tiranë 1977.
- Paparisto, A. Mbi disa tipare stilistike të këngëve polifonike të burrave të Shqipërisë së Jugut, Konf. I e folkloristikës shqiptare, Tiranë 1972.
- Peristeri, S. Këngë popullore të Dropullit V.E. Akademia e Athinës 1958.

Panajot Barka

3) Revista periodike “Kërkime Universitare”, Universiteti i Gjirokastrës, nr.13, 2006

“Migrimet e Minoritetit Grek dhe marrëdhëniet me popullsisnë shqiptare”

Migrimi, me kuptimin specifik apo të përgjithshëm të lëvizjeve demografike, nga pikëpamja diakronike përbën një vlerë që i siguronte vitalitet dhe përparim rajonit tonë. Vendosja e kufijve e frenoi këtë fenomen ndërsa politika e shpërfytyroi atë.

Minoriteti etnik grek në Shqipëri, si produkt i realiteteve politike gjatë krijimit të shtetëve të mevetësishme pas shembjes së Perandorisë Otomane, nuk e humbi këtë veti. E vëçanta është se kjo veti dalluese për rajonin tonë, u shndërua për minoritetin në një mundësi thjeshtë mbijetese. Kjo lidhet me faktin se migrimi i tij përcaktohej nga faktorë thjeshtë politikë ose të politizuar. Në varësi të tyre dhe të mundësive për të komunikuar me kombin am, migrimet e tij drejtoheshin herë drejt Greqisë e vendëve të tjera perendimore e herë drejt qendrave urbane të shtetit shqiptar ku ai ishte përfshirë.

Në këtë kontekst, ndryshimet politike të ndodhura me krijimin e shtetëve edhe në Ballkan gjatë shekullit XIX-XX dhe sidomos situatat gjatë e pas luftimeve ballkanike, pas caktimit të kufijve të shtetit shqiptar e vëçanërisht situatat e pas Luftës së Dytë Botërore, sollën një gjepolitikë të re, e cila ndikoi negativisht në karakteristikën kryesore të rajonit të Jugut të sotëm të Shqipërisë si pjesë e një rajoni më të gjerë të njohur më emrin Epir që ishte lëvizja e vazhdueshme e popullsisë.

Së pari. Në aspektin e hapësirës më të gjerë Ballkanike, u ndërpre edhe këtu, të paktën për disa dekada, lëvizja e popullsisë të ndryshme, nga jashtë rajonit apo dhe brenda tij. Siç dihet, që para se akoma të lindte koncepti i etnosit dhe i qytet shteteve deri në fillim të shekullit XX, në pjesën Perendimore të Ballkanit është ruajtur një lëvizje demografike, me kah kryesor drejtimi të lëvizjes atë nga Veriu në Jug. Bëhet fjalë për lëvizje popullsish në formë fisesh, popullsish barbare e pushtuesish. Të njëjtin kah kishte pak a shumë dhe migrimi i brendshëm, ose i popullsisë vendase. Kjo gjë ndodhte akoma edhe në periudha relativisht të qëndrueshme e të njësuara politikisht, siç janë periudhat e sundimit të perandorive të ndryshme duke filluar nga ajo romake e bizantine deri në perandorinë otomane.

Shkaqet që promovonin këto lëvizje ishin të ndryshme ekonomike, politike, kulturore, ushtarake, etj. Veprimi i tyre lidhet me faktin e niveleve të diferencuara veri jug. Jugu përfaqësonte djepin dhe lulëzimin e kulturës së Egjeut e të Mesdheut e më pas atë Greke dhe zotëronte tri dete dhe mundësi të mëdha komunikimi. Të dy këta faktorë siguronin një zhvillim të shpejtë në të gjitha drejtimet dhe ishin kthyer në një pol terheqës të popullsisë të vendosura në Veri. Kjo vlerë përcaktohej përpos të tjerash nga gjeofizika e rajonit, por sidomos pozicioni gjeostrategjik i kësaj treve si rajon kyç i kalimëve lindje perendim e veri jug.

Së dyti. Rajoni humbi vlerën e rolit të tij si përfitim reciprok nga kjo lëvizje.

Në kushtet e reja të shekullit të kaluar rajoni humbi aftësinë për të përjetuar si vlerë më përfitim reciprok këtë bashkëjetesë multietnike, multikulturore e multifetare që ridhte nga lëvizjet demografike e që i siguronin rajonit identitetin e vet të veçantë të ngritur mbi një subshtat të përbashkët e unik. Historiografia vë re se lëvizjet e brendshme të popullsisë p.sh para fundit të Bizantit, ose gjatë Dhespotatit të Epirit kur në krye të tij viheshin njëri pas tjetrit drejtues të kombësive të ndryshme, - grekë, italianë, serbë e shqiptarë, gjë që bëri që rajoni të njehsohej me një strukturë popullore shumëgjuhësore e multietnike¹¹. E njëjta strukturë u trashëgua dhe në periudhën e Perandorisë Otomane. Studjuesit grekë N.Vernikos dhe S. Dhaskallopullu, vënë re se në këtë trevë banonte dhe lëvizte “një botë pesëgjuhëshe”¹² bashkëjetesa dhe bashkëveprimi i të cilëve ka stigmatizuar zhvillim e përparim me rezatim në rajonin më të gjerë dhe në të gjitha periudhat kritike të historisë.

Realitetet gjeopolitike të fundit të shekullit XIX fillimit të shekullit XX, çuan në shndërimin e lëvizjeve demografike në lëvizje të brendshme në kufij shtetëror. Nga ana tjetër faktori kryesor që promovonte lëvizjet demografike ishte ai politik. Kjo bëri që marrëdhëniet ndëretnike apo ndërjetare të mos përbënin më vlera të qënësishme.

Minoriteti etnik grek si pjesë e këtij rajoni i përjetoi me një dramë të veçantë këto ndryshime. Kjo lidhet me faktin se anëtarët e këtij minoriteti nga të qenit pjesë integrale e kombit grek u kthyen në pakicë etnike. Realiteti i ri sidomos në periudhën midis dy luftërave botërore, u reflektua drejtpërdrejt jo vetëm në marrëdhëniet me shtetin, por edhe në marrëdhëniet me elementin në shumicë tanimë të popullsisë shqiptare.

Kjo bëri që në periudhën midis dy luftërave anëtarët e Minoritetit Grek shoqëruan realitetin e ri me një emigrim masiv drejt Greqisë, apo vendeve të tjera perendimore. Gjithashtu duhet thenë se emigronte kryesisht truri i këtij minoriteti dhe ato shtresa të cilat nuk mund të pajtoheshin me pasigurinë e tranzicionit të rendë politik, ekonomik, shoqëror e etnik. Në bazë të statistikave të kohës rezultoi që 70 përqind e emigracionit nga Dropulli i takon periudhës 1920-1938. Vetëm në SHBA emigruan në këtë periudhë rreth 2 500 veta. Nga fshati Bularat më 1939 numëroheshin në kurbet 500 veta, nga Dervicani 410 veta, nga Sopiku 200, nga Policanit 280, nga Goranxia 110. Më 1936 në fshatin Sotirë kishin mbetur vetëm 20 burra ndërsa 216 të tjerë ishin në mërgim. Kaq masiv ishte emigrimi jashtë shtetit shqiptar në këtë periudhë sa që zëvendësprefekti i prefekturës së Gjirokastrës K.Tasi, i kërkonte më 1924 Tiranës zyrtare udhëzime për të përballuar problemin: “Këto ditë,- shkruan,- në prefekturën tonë konstatohet një tendencë e madhe dhe bëhet propagandë për emigrim në Australi”¹³

¹¹ Ηπειρος, Εκδοτική Αθηνών Α.Ε, Αθinë, 1997, fq. 219.

¹² Νικόλας Βερνίκος Σοφία Δασκαλαπούλου, Στις απαρχές της νεοελληνικής ιδεολογίας, Αθinë, 1999, fq. 22.

¹³ AQSH: Fondi 494, Dosja 912, viti 1924, fq. 1.

Ndërkohë migrimet në thëllesi të territorit të vendit janë të pakta. Shkaqet duhen kërkuar te ndryshimet politike që çuan tek acarimi i marrëdhënieve nderetnike të cilat mund të konsiderohen nga më të veshirat në të gjitha kohrat.

Siç vë re studiuesi i njohur nga Skorea e Pogonit, Dhimitër Beduli, këto migrime lidhen kryesisht me egzistencën e interesave të rendësishme ekonomike të familjeve nga ky minoritet në qytete që pretendonin një zhvillim tregtar dhe lidhje të shumfishta me perendimin siç ishte Vlora, Durrësi, etj. Këto migrime ndodhnin nga fshatra e krahina malore, të cilat, fakt është se ishin të parat që kishin hapur rrugën e emigracionit që në në shekullin XVI-XVII, sidomos në shek XIX dhe ia kishin parë hajrin tregëtisë. Interesant është në këtë drejtim fakti se jo vetëm nuk kemi çvendosje të familjeve me kombësi greke në qytete të tilla si Delvina e Gjirokastra, përkundrazi vihet re një pakësim i numrit deri në zhdukje të popullsisë me kombësi greke në këto qytete dhe në zona të tjera në kontakt me krahinat me popullsi kompakte me kombësi greke.

Periodha e pas luftës së dytë botërore sjell raporte të reja politike e shoqërore. Migrimi i popullsisë së minoritetit lidhet edhe më shumë me arsyet politike të sistemit komunist. Ky fenomen i shërbën politikës homogjenizuese të popullsisë sipas parimit ideologjik të njëriut të ri socialist. Parimet staliniste të trajtimit të minoriteteve, të ruajtjes formalisht të identitetit të tyre dhe shkrirjes së tyre reale me pjesën tjetër të popullsisë, gjetën zbatim praktik edhe në trajtimin e minoritetit grek nga shteti komunist. Nga ana tjetër u krijuan kushte të tilla që ndryshuan raportet e marrëdhënieve të brendshme të minoritetit me popullsinë shqiptare dhe me kombin am. Lufta në vetvete kultivoi një klimë të re marrëdhëniesh, në sensin pozitiv, midis elementit me kombësi greke dhe atij me kombësi shqiptare. Nga ana tjetër kemi një izolim dhe ndërprerje totalitare të marrëdhënieve të anëtarëve të minoritetit etnik grek me kombin am Greqinë por edhe me botën. Ky izolim vjen duke u rritur. Ai preku edhe marrëdhëniet e kontaktet me njëriut të afërm jashtë kufijve të shtetit shqiptar duke sjell pasoja jo të vogla në aspektin e ekonomisë familjare.

Në këtë kuadër shteti komunist njeh arbitrarisht si minoritet etnik grek krahina të përbëra kryesisht prej 100 fshatrash në katër rrethet e jugut të vendit. Ato u zhvilluan edhe pse me përparësi, në mënyrë të njëanshme me drejtim bujqësor. Prodhimi bujqësor edhe këtu sigurohej jo me mënyra e mjete intensive por nëpërmjet rendimentit të krahut të punës. Po ashtu si në të gjithë vendin u zbatua politika e ruajtjes mekanike të popullsisë së fshatit pavarësisht nga niveli dhe mënyra e sigurimit të mjeteve të jetesës. Këto kushte çuan në një kontradiktë të papajtueshëm midis rritjes natyrore të popullsisë dhe mundësive për të jetuar në fshat. Këtë papajtueshmëri e bënte më të theksuar niveli relativisht më i lartë kulturor i këtyre krahinave dhe tradita e gjatë për të mos u pajtuar me realitetin e imponuar për sigurimin e jetesës. Fjala është për kurbetin.

Kjo bëri të nxitej një migrim i anëtarëve të minoritetit grek në qendrat të mëdha urbane. Dhe siç do të vëmë re, shteti zbatonte një politikë shtrenguese qëndrimi në fshat kryesisht për një kategori njëriutish me nivel të ulët arsimor e kulturor ndërsa krijonte premisa largimi për kategori të tjera. Kjo liri kushtëzohej gjithashtu nga disa faktorë. Së pari, siç e thamë, kërkohej devotshmeri ndaj pushtetit politik si posedues i të gjitha vlerave individuale e shoqërore. Së dyti, në formë të pashprehur i kërkohej të kalonte në plan të dytë, ose ta fshihte identitetin e vet identitetin e vet etnokulturor ose ta demonstronte atë në mënyrë formale apo në shërbim të ideologjisë komuniste. Pikërisht ky realitet krijoi tek populli shqiptar përshtypjen se sistemi komunist ndërsa i mohoi atij të drejtat e njëriut i siguroi në një shkallë diskriminimi pozitiv të drejtat etnokulturore minoritarëve.

Rrugët e migrimit janë:

- *Migrimi i trurit të minoritetit etnik grek në formën e thithjës së organizuar nga strukturat e shtetit komunist.*

Së pari. Ngritja e shtetit komunist kishte nevojë për kadro të aftë dhe të besuar. Minoriteti grek për vet kushte historike zotëronte një potencial relativisht me të madhë kuadrosh. Po ashtu, duke qenë se ishin pjesëtarë të një pakice ata me siguri përbënin një garanci më të madhe për sistemin. Nga ana tjetër frika e organizimeve kundër sistemit e bënte shtetin komunist edhe më të interesuar për të tërhequr trurin e ajkën e minoritetit sa më larg krahinave me popullsi homogjene. (Për të njëjtin qëllim të gjithë ata që nuk treguan devotshmeri i përdoqi në burgje apo internime).

Së dyti realiteti i trashëguar në minoritet presupozonte një arsime dashje në shkallë të gjerë. Mirëpo nevojat për kadro të lartë në minoritet ishin disa herë më të pakta së numri i tyre real. Aq më tepër që shumë prej tyre diplomoheshin në degë për të cilat s'kishte fare nevojë ky minoritet. Rezultati: - Ata arsimoheshin për t'i shërbyer pushtetit komunist.

Po sjellim disa fakte. (Theksojmë që shifrat në vijim janë grumbulluar nga burime të drejtpërdrejta dhe burime dytësore nga organizata joqeveritare, "Afirmuesit e identitetit tonë" me qëndër në Gjirokastrë. Një pjesë të tyre demonstrohen për herë të parë)

Në vitet '80 në veri të Shqipërisë numëroheshin afërsisht 250 kadro të lartë pjesëtarë të minoritetit etnik grek. Më 1995 qëveria e partisë demokratike, në emer të organizimit të një ushtrie të pastër nga ana etnike, përfshi edhe policinë, debtoi mbi 300 oficerë të niveleve të ndryshme me kombësi greke. Fshati i Goranxisë gjatë periudhës 1944-1985 numuronte me diplomë universiteti rreth 130 veta. Nga këta rreth 20 ushtronin profesionin e tyre pranë krahinave të minoritetit. Përmenndim po ashtu fshatin Dhrovjan me 122 të diplomuar deri më 1990. Nga këta vetëm 17 veta ishin të punësuar në të ashtuquajtura zona minoritare Derviciani 160 nga këta rreth 25 veta ushtronin profesionin afër minoritetit. Diferencat janë më të mëdha për fshatrat malorë si Policani, Sopiku, Dhivri. Theologo, Lesinica, etj.

Një kategori tjetër përbën migrimi i "detyruar" Këtu përfshihen dy nëndarje. E para ka të bëjë me çvendosje të detyruar për nevoja të shtetit, siç është rasti i vozaxhnjve të Pogonit, apo i punonjësve të specialiteteve të ndryshme si ustallarë, rrobaqëpës, apo dhe i kuadrove të përmendur me lart.

Kategoria e dytë lidhet me të përndjekurit, sidomos kategorinë e të internuarve. Kishim edhe këtu internime masive, siç që rasti i fshatrave të Perdihkarit në rrethin e Sarandës dhe të Katunës në rrethin e Gjirokastrës, në mesin e viteve '50, apo dhe internimet masive pas vendosjes së pushteti popullor dhe sidomos pas zgjedhjeve të 1945. Përmenndim këtu disa shifra . Derviciani kishte të burgosur dhe të internuar 45 veta, Dhrovjani 60 veta, Skorea 60, Poliçani 60, Dhivri 48, etj të cilët në shumë pak raste janë kthyer në vendlindjet e tyre.

Migrimi në një formë të fshehur nga zonat me popullsi homogjene me kombësi greke ndodhi nëpërmjet martesave të kryqëzuara ose mikse. Ishte forma më e mirë për t'u larguar nga punët rrapakitesë dhe pa perspektivë të fshatit. Në vitet '70 - '80 fenomeni u bë aq masiv sa vajzat e minoritetit thoshin ή πόλη η φλυμπούλι (ose qytet ose helm) dhe po e kësaj periudhe është dhe shprehja tjetër "Pika mua kasteri kopella mori andra ifto", që po të përkthehet do të thotë "më rentë pika që një vajzë e bukur e paster etnikisht por edhe nga pikëpamja fetare mori për burrë një jevg, me kuptimin e një burri dosido por dhe të fesë tjetër). Por edhe sistemit i interesonte një fenome i tillë "Në rast se një vajzë minoritare dashuron një djalë shqiptar, lë të martohen, ajo është një e drejtë e saj si për çdo qytetar tjetër të

republikës”¹⁴ theksonte në një fjalim të Sekretariatit të K.Q të partisë E.Hoxha. Lë të shikojmë përmasat e këtij fenomeni nëpërmjet gjuhës së shifrave.

Fshati viti '86	Nr.popull/ deri 1990	Nr. martesave mikse	Nga djem	Nga vajza	Ortodok	Myslim	Brenda fshatit	Jashtë fshatit
Jergucati	~ 1100	98	26	72	27	71	30	42
Dhroviani	~ 780	84	37	47	49	35	15	79
Derviciani	~ 1900	248	103	145	157	91	55	193
Skorea	~ 400	78	42	36			-	-

Në këtë kuadër në një anketim të bërë nga Instituti i Studimeve Shoqërore 2000 në rrethet Gjirokastrë, Sarandë, Delvinë, Permet me pjesëtarë të Minoritetit Etnik Grek ndër të pyeturit në fshat e qytet 49,6 % ishin martuar me pjesëtarë të grupeve të tjera etnike.

Për të kuptuar shkallën e madhe të migrimit nga zonat me popullsi homogjene drejt qendrave të mëdha urbane të vendit lë të japim edhe një tabelë tjetër. Atë të numrit të familjeve nga zonat me popullsi homogjene me kombësi greke të migruara në qendrat e mëdha urbane para vitit 1990 .

Fshati	Numri i familjeve në fshat	Nr.i familil Migruar -v. 90	Numri me diplomë univers	Punësuar në krahi në	Nr. i të Burgosurve +intrenuar	Nr.i familil shqipt në fshat sot	Para 1990
Jergucati	~ 230	113	55	13	27	37	24
Dhrovian	~ 130	215	122	17	50	-	-
Skorea	~ 84	82	33	6	65	-	-
Poliçani	~ 140	~180	89	16	60	23	6
Dhivri	~ 350	~117	85	15	95		
Dervician	~380	220	160	25	45	13	9

Po ashtu nga Sotira kishin migruar 93 familje, nga Bularati 104, nga Dhuvjani afro 90, etj Duke i llogaritur në përqindje me numrin e familjeve në fshatrat reciproke, rezulton se nga fshatrat e minoritetit grek një pjesë prej 37- 43 përqind e familjeve në zonat me popullsi homogjene me kombësi greke janë vendosur në qendrat e mëdha urbane.

Ajo që duhet thenë është se nuk kemi një migrim të grupuar, dmth që nga një fshat i caktuar të kemi një vendosje në një qytet të caktuar, por kemi kemi preferencë të anëtarëve të Minoritetit Etnik Grek për disa qyteteve si p.sh. Tirana, Durrësi, Vlora, Korça, Gjirokastra, Saranda, etj.

Gjithë kjo pasqyrë nuk shpjegon vetëm shkallën e madhe të migrimit të anëtarëve të minoritetit etnik grek në Shqipëri drejt qendrave të mëdha të banuara

¹⁴ E. Xoxha, Fjalim në Sekretariatit të K.Q të PPSH-së, 5 maj 1969.

por jep edhe një shpjegim të faktit se pse gjatë regjistrimit të popullsisë numri i pjesëtarëve të minoritetit etnik grek nuk i pergjigjet rritjes natyrale demografike të tij, pra madhësisë reale të tij.

Kështu sipas vjetarit statistikor të seksionit të planit të Komitetit Ekzekutiv të Gjirokastrës I vitit 1976 del që rritja natyrale mesatare e përvithsme e popullsisë në këtë rreth, nga 1955-1975 është e barabartë, (rreth 16 për mijë) si për popullsinë me kombësinë shqiptare ashtu edhe për atë me kombësi greke që njëkohësisht përputhet me mesataren e Republikës. Mirëpo na del që në periudhën që popullsia në Shqipëri të jetë afërsisht katërfishuar, ajo e minoritetit grek të jetë rritur vetëm 1.7 herë. Po ashtu popullsia me kombësi greke prej 58758 banorë sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 1989 i përket numrit të popullsisë banuese në të 100 fshatrat të njohura në mënyrë arbitrare nga shteti komunist si minoritet grek dhe nuk merr parasysh atë pjesë të popullsisë së migruar në qendra urbane.

Me rendësi besojmë se është edhe trajtimi i dëpërtimit të elementit me kombësi Shqiptare në zonat të ashtuquajtura të pastra. Na rezulton se qoftë edhe e pakët ky dëpërtim ekziston. Psh deri në vitin 1990 në Jergucat kishim 24 familje me kombësi shqiptare, në Dhrovian asnjë, në Dervician 13 në Poliçan 23. Por raste të tilla kemi edhe në Livadhja, në Finiq, Mesopotam, Çukë, etj. Po ashtu i konsiderueshëm mbetet edhe numri i martesave mikse të vendosura në fshatra të pastra minoritare. Në Jergucat ky numër arrin në 30, në Dhrovian, në 15, në Dervician në 55, etj. Po ashtu nuk mund të mos vemë re se në emer të ngritjes së fshatrave të rinj socialist shteti komunist ngriti disa fshatra me popullsi heterogjene brenda territorit të zonave të ashtuquajtura të pastra siç është Bulua, Bistrica, SMT-ja (Çlirimi), Çuka, etj.

Pyetja e fundit që del është si do ta konsiderojmë këtë fenomen si integrim apo asimilim?

Fakti që shteti komunist dje dhe i njëjti mentalitet vazhdon edhe sot, nuk e njeh atë pjesë të minoritetit etnik grek të migruar në qendrat e banuara si pjesë integrale të këtij minoriteti, atëherë duhet pranuar se kemi të bëjmë me një politikë de jure asimilimi. Drejt konkluzionit të një politikë asimilimi edhe de fakto të çon edhe fakti që një pjesë e konsiderueshme e brezit të dytë dhe të tretë të kësaj pjese të migruar të minoritetit grek në qendra të mëdha urbane nuk e njeh gjuhën e as traditat dhe zakonet e tij, madje as vendlindjen e prejardhjen e tij qoftë gjenealogjike qoftë etnike. Këtë konkluzion e përforcon akoma më shumë realiteti i humbjes së shumë elementeve përcaktues të identitetit etnik edhe në zonat me popullsi homogjene greke deri në masën sa që ata nuk guxonin të quheshin minoritarë grek por thjesht minoritarë. Por edhe nga ana e shumë elementeve e strukturave të shoqërisë shqiptare e pranojnë këtë minoritet vetëm kur ai “fsheh” identitetin e tij dhe nuk diferencohet nga popullsia shqiptare si pjesë integrale e kombit grek.

Ky realitet kupton se krijon një shije jo të mirë kur u referohemi marrëdhënieve shumë të mira të krijuara midis pjesëtarëve të Minoritetit Etnik Grek me pjesën tjetër të popullsisë shqiptare. Fakti i një numri kaq të madh martesash me kombësi të ndryshme, pavarësisht se kohët të fundit kjo lloj martese në moshat e reja është tronditur paksa nga divorcet, tregon se këto marrëdhënie të mira kanë krijuar një vitalitet qëndrueshmërie dhe se tendencat asimiluese i përkisnin politikës zyrtare dhe jo njërvëzve të thjeshtë, popullit.

Hapja e Shqipërisë me botën solli si pasojë rivendosjen e kontakteve shmëplanesh të anëtarëve të minoritetit etnik grek me kombin am. Izolimi politik, diferenca e madhe ekonomike por edhe qëndrimi politik i shtetit komunist ndaj tyre për 45 vjet bëri që të kemi një lëvizje masive deri në shperngulje të popullsisë së këtij komuniteti drejt Greqisë. Kjo lëvizje përfshiu kryesisht moshat e para e të dyta. Ky

migrim përfshiu një masë të madhe popullsie që varion nga 30,40 dhe 50 % në zonat fushore, deri në 60 - 70 % në zonat malore. Këto shifra ndryshojnë edhe në varësi të stinëve. Më masive janë rastet e pjesëtarëve të Minoritetit Etnik Grek me banim në qendrat urbane të vendit. Po ashtu duhet thenë se për herë të parë në historinë e emigracionit të Minoritetit Etnik Grek vihet re një emigrim familjar dhe jo i pjesshëm i familjës së tij.

Në këtë emigrim masiv ndikoi dukshëm edhe tranzicioni i gjatë dhe i veshtirë i Shqipërisë si dhe koniukturat politike në vet minoritetit. Situatat e trazura në këtë minoritet në periudhën 1993-95 dhe trazirat e marsit 1997 nxitën ndoshta emigrimin më masiv të detyruar nga minoriteti grek që llogaritet në rreth 9 mijë veta.

Ndërkohë jemi në një periudhë të përfundimit të fazës së migrimit drejt Greqisë dhe faza e stabilitetit shoqërohet me rikthim në vatrën e tyre. Në këtë kuadër duhet të përbëjë shqetësim për marrëdhëniet integruese ndëretnike fakti i ndërrimit të kahut të lëvizjes migruese, plotësisht në të kundërt (nga migrimi drejt qendrave urbane të vendit ku jeton, në emigrim drejt kombit am), si dhe masiviteti i tij.

Nga ana tjetër ndërsa vihet re një kufizim i migrimit nëpër qendrat urbane të vendit, kemi një rritje të migrimit të elementit me kombësi shqiptare në zonat e këtij minoriteti. Dallohen dy lloje: - të përhershme ose të qëndrueshme dhe jo të qëndrueshme ose të përditshëm. Numri i familjeve shqiptare me banim të përhershëm në zonat e pastra minoritare, krahasuar me periudhën para vitit 1990 llogaritet të jetë rritur në masën 25 %. Ndërsa është rritur shumë numri i elementit me kombësi shqiptare i punësuar në këto zona. Është llogaritur që rreth 500 veta punojnë ditë për ditë vetëm në zonën e Dropullit.

Konkluzione

Nga sa u përpoqëm të kumtonim më sipër mund të tërheqim disa konkluzione.

- Migrimi përbën një fenomen historiko-shoqëror nga më të vjetrat në rajonin tonë që i siguronte atij vlera pozitive dhe identitetin e vet.
- Kufijtë shtetëror dhe hermetizimi i tyre e politizoi migrimin dhe shpërfitoi funksionin e tij diakronik.
- Migrimi vazhdoi të shoqërojë komunitetin e minoritetit etnik grek në Shqipëri. Kushtet e reja politike nga njëra anë dhe marrëdhëniet me kombin am përcaktuan drejtimin e migrues të tij.
- Migrimi i tij në periudhën e pas Luftës së Dytë Botërore kishte karakter politik. Si i tillë ishte me pasoja për identitetin e tij etnokulturor dhe për madhësinë demografike të këtij komuniteti. Kjo për faktin se duke qenë se shteti komunist njëzëri zyrtarisht përkatësinë etnike greke pothuaj vetëm për pjesëtarët e minoritetit grek me banim në zonat e caktuara arbitrarisht dhe që përfshinin vetëm 100 fshatra, pjesa tjetër e përfshirë në migrim drejt qendrave të mëdha urbane nuk njihet si e tillë dhe rrjedhimisht as kishte mundësi e kushte të zhvillonte e të demonstronte realisht këtë identitet me përjashtim të rastëve që i interesonin shtetit.
- Migrimi edhe i kësaj natyre, pavarësisht nga tendencat asimiluese të politikës shtetërore, siguroi një integrim midis anëtarëve të minoritetit grek dhe popullsisë shqiptare. E përforcon këtë argument edhe prania pa probleme e elementit shqiptar në zonat me popullsi homogjene të minoritetit grek. Pasojat asimiluese do t'i vlerësojë koha.

Referenca

AQSH: Fondi 494.Dosja912, viti 1924.

B. Mema, A. Shahu, Prefektuar e Gjirokastrës 1920-1924, Berat 2001.

Regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë dhe i banesave 1989, Tiranë 1991.

Kom Ekz.K.P. rrethit Gjirokastrë, Vjetari statistikor., viti 1976.

Δ. Μπεντούλης, Σχωριάδες Πωγωνίου, Athinë 2002.

Εκδοτική Αθηνών Α.Ε, Ήπειρος, , Athinë 1997 .

Η. Σταύρου, Η Δρόβιανη, Athinë 2002.

Κ. Κουλίδας, Σωτήρα, Janinë 1998.

Μ. Δαλιάνης. Η εθνική αντίσταση της ελληνικής μειονότητας στην Αλβανία (1940-1944), Athinë 2000.

Νικόλας Βερνίκος, Σοφία Δασκαλαπούλου, Στις απαρχές της νεοελληνικής ιδεολογίας, Athinë 1999.

Π. Μπάρκα, Λαογραφικά, Tiranë 2003.

Χ. Μ. Κίτσιος , Η Δίβρη, Athinë 2001.

Panajot Barka

4) Revista periodike “Kërkime Universitare”, Universiteti i Gjirokastrës, nr. 15, 2008

“Letërsia e Minoritetit Etnik Grek gjatë Luftës së Dytë Botërore”

1. Ndryshimet gjeopolitike të fillim shekullit të kaluar dhe prodhimi kulturor-letrar në Minoritetin Grek

Vendosja e kufijve dhe krijimi i shtetit shqiptar në fillim të shekullit të kaluar u shoqërua me prishjen e ekuilibrave politike, etnike, sociale e ekonomike të krahinës së Epirit që në shekuj shquhej për integritetin e vet të njehsuar në këto fusha. Në pjesën e veriut të Epirit, që ju bashkëngjiti shtetit shqiptar, jetonte një pjesë e rëndësishme popullsie me etni greke. Po për herë të parë në historinë e Epirit një popullsi me etni greke do të jetonte këtu me statusin e minoritetit etnik. Përjetimi prej këtij minoriteti i realitetit të ri historik ndoqi rrugën e vështirë të përpjekjeve të tij për të mos u pajtuar me ndarjen nga pjesa tjetër e kombit të vet; të peripecive nga Luftat Ballkanike e Lufta e Parë Botërore; të ambicjeve të shtetëve të fuqishme për të ruajtur supremacinë e tyre në këtë rajon strategjik midis Lindjes dhe Perëndimit; por edhe të peripecive nga përpjekjet për të arritur stabilitetin e brendshëm politik të shtetit të ri e të brishtë shqiptar .

Në këto situata jeta e këtij komuniteti u fut në amulli e stanjacion të përgjithshëm. Zhvillimi i tij ekonomik e aq më tepër zhvillimi kulturor, ishte i paimagjinueshëm. Bashkëjetesa ndëretnike si një karakteristikë dalluese dhe faktor stimulues i përparimit të gjithanshëm nëpër histori, u vu në rrezik serioz. Nga ana tjetër, me kohë kishte filluar tërheqja e infrastrukturës që mbeshteste kulturën greke nga Gjirokastra e qytetet të tjera në këtë pjesë të Epirit drejt Janinës e qytetëve të tjera kufitare të Greqisë. Kushtet e krijuara provokuan një emigrim masiv të elementit grek. Ky emigrim prekte kryesisht elementin e shkolluar e intelektual (e njëkohësisht bartës dhe krijues kryesor i vlerave kulturore), i cili është gjithmonë më i ndjeshëm ndaj trazirave, paqëndrueshmërisë e mungesës së një perspektive të qartë.

Po ashtu, në zhvillimet që shoqëruan këtë periudhë historike pesha e letërsisë në gjuhën greke në këtë pjesë të Epirit edhe pse historikisht në rolin e promotorit, filloi të tkurrej, pa sjell ndonjë kontribut me peshë të veçantë. Krijuesit letrarë, tanimë përfaqësues të minoritetit grek në Shqipëri, po gjenin strehë në qendrat e mëdha

kulturore të Greqisë, siç ishte Athina, Patra, Selaniku etj. Ndërsa letërsia në gjuhën shqipe filloi të rritej me shpejtësi dhe të zinte një peshë me rëndësi në letërsinë mbarëshqiptare.

2. Zhvillimet e reja që inicoi Lufta e Dytë Botërore dhe produkti letrar i Minoritetit Grek

Lufta e Dytë Botërore krijoi një realitet të ri për minoritetin grek në Shqipëri. Pas peripecive të brendshme dhe nën ndikimin e Frontit Nacionalçlirimtar të popullit grek, pjesa dërmuese e këtij minoriteti mori pjesë në mënyrë të organizuar në luftën e përbashkët me popullin shqiptar, të drejtuar nga Fronti Antifashist Nacionalçlirimtar Shqiptar.

Pas disa dekadash marrëdhëniesh që kishin vënë përherë e më shumë në dyshim mundësinë e bashkëjetesës paqësore, po ndodhte bashkëpjesëmarrja në të njëjtën luftë. Kjo kthesë me përmasa vërtet historike për marrëdhëniet e mëtejshme midis elementit grek e atij shqiptar në jug të Shqipërisë, kishte si faktorë përcaktues armikun e përbashkët dhe aspiratën që ushqeui për minoritetet Karta e Atlantikut, për të drejtën e vetëvendosjes pas luftës të atyre minoriteteve që do të luftonin kundër fashizmit përkrah popujve në shtetet që jetonin.

Nga ana tjetër, ky realitet i ri marrëdhëniesh po konturohej nga një ideologji e re, - ajo komuniste. Kjo do të thotë se për minoritetin etnik grek në Shqipëri lufta në vetvete, ashtu si ideologjia udhëheqëse e saj, përcaktonin jo thjesht një situatë të re, por vetë thelbin e momentit të ri historik që buronte nga këto marrëdhënie. Rrjedhimisht, atij i duhej të përpunonte e të krijonte sisteme të reja vlerash referuese. Kjo presupozonte krijimin e modeleve të reja mitesh, heronjsh e ideologjish, të aftë për të shërbyer jo vetëm si ushqim shpirtëror, por dhe si nevojë, që nëpërmjet riprodhimit shpirtëror të këtyre vlerave apo sistemit të ri të referimit, të krijohesh besueshmëria optimiste në lidhje me perspektivën e këtij realitet të ri.

3. Kërkesat për një letërsi të re – burimet e shfrytëzuara

Në plan të parë doli roli i letërsisë dhe jo i një letërsie të çfarëdoshme, por të një letërsie me një angazhim historik të diktuar më shumë nga aspirata entuziaste sesa nga qëllime qartësisht të përcaktuara.

Kësaj letërsie i duhej të çante shtigje të reja. Se pari, i duhej t'i përgjigjej nivelit të vlerave që krijonte realiteti i luftës dhe nivelit të marrëdhënieve të reja shoqërore e ndëretnike. Se dyti, nuk mund të shmangte as filozofinë e ideologjisë komuniste, e cila, e ndihmuar nga realiteti i luftës, e kishte më të lehtë për t'u bërë sunduese. Së treti, misionin e vet kjo letërsi duhej ta kryente në kushtet e mungesës së një tradite letrare që t'i përgjigjej këtij realiteti të ri.

Në këtë drejtim kjo letërsi nuk mund të mbështetej as në letërsinë shqipe. Për këtë nuk pengonte vetëm mungesa e marrëdhënieve tradicionale e as mundësia e pakët e komunikimit. Porse vetë letërsia shqiptare nga njëra anë, krahasimisht me vende të tjera, nuk dispononte ndonjë traditë të pasur letrare. Nga ana tjetër edhe vetë ajo duhej të përballonte problematikën e luftës e cila ishte e ndikuar nga filozofia e ideologjisë komuniste dhe nga synimet e përfaqësuesve të kësaj ideologjie për marrjen e pushtetit.

Mëgjithatë, edhe në këto kushte letërsia në minoritetin grek gjeti forma për një rrugë të natyrshme zhvillimi. Dihet që në çdo moment kalimtar historik, çdo grup apo komunitet i formuar etnikisht kërkon si dodmosdoshmeri objektive një sistem të ri

kolektiv sjelljeje që t'i përgjigjet dinamikës së re të zhvillimit. Në sferën shpirtërore kjo realizohet nga subkoshienca kolektive, e cila i referohet atij sistemi vlerash diakronike e të qëndrueshme që përbëjnë nënshtratin shpirtëror e kulturor të komunitetit.

Kështu shpjegohet pse realiteti i ri i luftës i beri krijuesit minoritarë t'i drejttoheshin pasurisë së pafundme të universit të krijimtarisë popullore dhe të përzgjidhnin pjesët më domethënëse për kushtet e reja që po krijoheshin. Si të tilla shërbyen ciklet e këngëve popullore historike të kaçakëve në Greqinë e fundit të shekullit XVIII edhe fillimet e shekullit XIX. Në këtë rast nuk është se kemi thjesht një përngjashmëri, sado të pakët, të kushteve historike. Më evidente bëhet nevoja e modeleve të gatshme dhe të njohura heroizmi për t'i mishëruar ato të heronjtë dhe të luftetarët e rinj, për një të ardhme jo fort të ditur e të përcaktuar. Kjo mbështetje të universi i pasur i vlerave të krijimtarisë popullore të trevës së tyre u siguronte krijuesve minoritarë epërsinë që të bëheshin farkëtuesit dhe shprehësit bindës të këtij sistemi të ri vlerash, pavarësisht nga fakti se sa u shërbenin aspiratave të bartësve të tyre. Kësisoj, mbështetja të modele të sprovuara në të kaluarën përbënte një garanci për prodhimin e ri letrar e shoqëruar kjo me mundësinë për të krijuar besimin e duhur ndaj parimeve të ideologjisë së re. *Në këtë pikë, zhvillimi natyror i letërsisë vihet në dyshim serioz. Angazhimi i saj si funksion permanent shoqëror do të shenojë fillimin e angazhimit në funksion të ideologjisë e të politikës.*

4. Veçori dhe risi të kësaj letërsie

Paralelisht, letërsia e re që po krijohet në bazë të rimarrjes së modeleve të gatshme dhe të sprovuara në traditën e krijimtarisë popullore, i shërbente realisht edhe ruajtjes pa shkëputje të vazhdimësisë vertikale të parametrin etnik. Kjo për faktin se këngët e kaçakëve përbëjnë në tërësinë e tyre një zhvillim të natyrshëm të këngëve të akritëve dhe baladave popullore, të cilat nga ana e tyre kanë lidhje të drejtpërdrejta me korpusin e madhë të miteve dhe të letërsisë klasike të Greqisë së lashtë.

Mirëpo, siç e thamë, kjo luftë nuk mund të krahasohet me historinë e luftës së kaçakëve në Greqi dhe me kontributin e tyre për fillimin e revolucionit grek të 1821. Lufta Nacionalçlirimtare Shqiptare kishte parametra e konvencione të reja krejt të ndryshme. Lufta e minoritetit grek zhvillohet në kuadrin e luftës së popullit shqiptar. Në këto rrethana marrëdhëniet e minoritetit grek me kombin am fituan më shumë konvencionin e luftës globale kundër fashizmit dhe të ideologjisë komuniste dhe fare pak ato shfaqeshin si marrëdhënie të drejtpërdrejta etnike. Është kjo arsyeja që në krijimtarinë e kësaj periudhe, përveç ruajtjes së linjës së riprodhimit të motiveve tradicionale, kemi edhe ndikime të parametrave të prejardhura nga marrëdhëniet e reja. Vihen re motive, apo dhe këngë të plota, të ndikuara nga fryma e përgjithshme e aleancës së popujve kundër forcave të boshtit, e udhëhequr kjo aleancë nga ish-Bashkimi Sovjetik. Po ashtu në gamën e gjerë të këtyre krijimeve, kemi këngë të ndikuara apo të përkthyer nga shqipja.

Më mirë këto ndikime vihen re tek ana muzikore. Marshet dhe meloditë e tjera që u përdorën kishin një linjë të përbashkët të konvencionit global të luftës,-ideologjinë komuniste, pavarësisht nga ndonjë veçori. Karakteristikë është fakti që ky ndikim, në aspektin muzikor, u shtri edhe në krijime apo këngë të minoritetit grek të kësaj periudhe, të cilat u mbështetën fuqimisht të trashëgimia e poezisë popullore greke.

Megjithatë, fakt është se në këtë krijimtari gjejmë të gjitha tiparet dhe veçoritë e këngës popullore tradicionale greke, veçanërisht, të ciklit historik të

kaçakëve. Dallohen në to mishërimi në një unitet poetik ose pjesëmarrje e përbashkët në veprimin poetik (kryesisht nëpërmjet personifikimit dhe hipërbolës) të njerëzve, të natyrës, të ideve dhe të perëndive. Dialogu midis heroit të cilit i kushtohet kënga (poezia) dhe ambientit, cilido qoftë ai, si karakteristikë dalluese e eposit të lashtë, këngëve të akritëve dhe baladave, mbetet një karakteristikë përgjithësuese e krijimeve poetike të kësaj periudhe. Ashtu si në traditën e krijimtarisë popullore edhe në krijimtarinë e kësaj periudhe, natyra, në aspektin e konotacionit figurativ, përbën një parajsë të mbitokë që garanton teresinë dhe siguron fatbardhësinë e qenies së gjallë-njëriut. Në nivelit e veprimit refyesh poetik marrëdhënia e njëriut me natyrën, (peripecitë njërëzore në natyrën e personifikuar), shpaloset si një komunikim pafund që tenton një identifikim të lumnueshem me të. Në aspektin e sistemit të vlerave kjo lidhje shfaqet si marrëdhënie identiteti midis vlerave të natyrës dhe të njëriut.

Po ashtu, përballimi i vdekjes, si vazhdim i jetës, ndodh si te këngët tradicionale të kaçakëve. Këto raporte caktohen sipas kategorive të kundërta, *liri-roberi*, *jetë-vdekje*. Sipas kësaj skeme roberia është e njëvlefshme me vdekjen (dhe përbejnë polin negativ) dhe liria me jetën (përbejnë polin pozitiv). Çelësi i këtij modeli qëndron te identifikimi absolut i jetës me lirinë dhe te ndarja absolute e saj nga gjendja e roberisë. Te këngët popullore kjo hierarki vlerash zë fill te parimi se jeta vet nuk ka vlerë, ose nuk ia vlen ta jetosh, nëse nuk i korrespondon cilësisë reale të njëriut (e percaktuar në raportin e tij me natyrën). Këtu buron koncepti i sakrificës së jetës personale në emer të dinjitetit dhe pavarësisë njërëzore. Në këtë mënyrë, njëriu i këngës popullore, ose heroi popullor, duke parapëlqyer vdekjen përball roberisë dhe perdhosjes, mohon në mënyrën më të dukshme shkeputjen e jetës nga liria dhe dinjiteti i tij. Vargjet e mëposhtme na paraqesin më së miri këto raporte.

Οι παρτιζάνοι βγήκανε / στις πιο ψηλές κορφούλες/ γιατί 'χαν σκλάβους αδερφούς/ και σκλάβες αδερφούλες/...

(Partizanet seç dolen / në majat më të larta/ se kishin sklever vëllëzërit/se kishin sklave motrat/...)

Ajo që është interesante është mbartja në letërsinë e Luftës së Dytë Botërore të minoritetit grek të tipologjisë së aksionit mbrojtës të këngës popullore greke. Kjo do të thotë se aksioni, ose motivi nxitës për veprim, te këto këngë përcaktohet nga kundërshtimi i heroit për të lëjuar kundërshtarin t'i rrembej diçka të vyer që ai zotëron. (më sakt kjo shfaqet edhe te epika për Gjergj Elez Alinë). Krejt e kundërta nga tipologjia e aksionit që heroi vepron në emer të rrembimit të një vlere që e zotëron dikush tjetër. Pra, ky hero i yni na shpalos vlerën e plotmerisë që buron në vetvete nga nga jetesa me drejtësi dhe në harmoni të plotë me ambientin natyror dhe shoqëror.

Këtë filozofi vlerash të këngës tradicionale popullore e gjejmë të mishëruar edhe në letërsinë e Luftës së minoritetit grek. Bile, duke mbartur të njëjtat mjete shprehëse që janë përdorur dhe në ciklin, të cilit i referohemi, por edhe në baladat dhe në këngët akritase. Marrim si shembull këngën për dëshmorin Spiro Partali. Thotë në një moment kënga : «.Σύντροφοι μη μ' αφήνετε στα έρημα τα δάση/ για πάρτε με και σύρτε με, ψηλά σε 'κείν' τη ράχη / καμείτε και τον τάφο μου, το μαύρο μου κιβούρι,/ να 'ναι βαθύ, να 'ναι πλατύ, να 'χει και παραθύρι,/ να βλέπω τα συντρόφια μου, να χαίρετε η καρδιά μου....»

(Shokë mos më lini mes pyjeve të shkreta / merrmeni dhe çomëni në majë t'asaj kodre/ bëmeni dhe varrin të ziun varrin tim/ të jet' i thellë, të jet' i gjerë, të ketë edhe dritare/ të shoh unë shokët e mi, zemra të më gezohet...)

Ashtu siç ndodh në shumë këngë kaçakësh, edhe këtu kemi motivin e partizanit të plagosur (në greqisht përdoret emri αντάρτης - andart) në mes të një pylli

që pret vdekjen. Ai, si te kaçakët, nuk i trembet vdekjes më shumë se idesë se do të jetë vetëm. Ndaj dhe kërkon që dhe pas vdekjes të ketë mundësi komunikimi (pasiv) me shokët (jetën). Dritaren që kërkon te varri i tij na kujton gjithashtu variante të ndryshme të baladës së murimit (Ura e Artës) apo dhe vetë varrin e Dhijeni Akritës.

Në krijimet e kësaj periudhe, përveç rimarrjes së motiveve nga këngët popullore të traditës, të vargjeve, fragmenteve nga ato, apo dhe këngëve të tëra ku ndryshohet vetëm emri dhe koha e ngjarjes (fenomene këto tipike të krijimtarisë popullore) gjejmë përshtatjen në të njëjtën këngë të motiveve nga këngë të ndryshme: të kurbetit, të nizamëve, të baladave etj. Në to gjejmë shpesh dhe armët që përdornin kaçakët (shpatën) dhe në të njëjta vargje formacionin luftarak partizan, madje, në gjuhën shqipe “brigadë”. (Kënga për dëshmorin Llambi Llambraqi)

Elementet e rinj që hasen në krijimet e periudhës së luftës partizane karakterizohen më shumë nga ngjyrimet ideologjike dhe ndikime nga hymnet e marshet revolucionare të kohës, qofshin këto shqiptare, greke apo ndërkombëtare. E veçanta është se ato interpretohen në gjuhën greke. Kemi psh, rimarrjen në masë të gjerë të fjalës “shokë”. E njëjta fjalë gjendet e përdorur rrallë edhe në këngët e kaçakëve. Në to ajo përdoret me kuptimin intim të mikut. Në këngët partizane përdorimi i saj bëhet në një kontekst ideologjik.

Po ashtu, dihet që te këngët popullore të kaçakëve, (njësoj si në mitologji apo në këngët epike të akritëve), ndërgjegjja dhe veprimi i individit vazhdon të luajë rol kryesor në përcaktimin e fatit të rrjedhës së ngjarjeve. Përkundrazi, në krijimet e luftës partizane ato zëvendësohen me veprime kolektive (të shokëve, popullit). Nga ana tjetër, amanetet, si pjesë integrale e kozmosit të eposit të kaçakëve, kanë si objekt anën personale dhe private. Në këngët e luftës edhe amanetet u përkasin elementeve të logjikës kolektive, lirisë, demokracisë, përparimit etj.

Që në këtë periudhë kemi shfaqjen e elementit deklamativ, panigjirik e retorik të poezisë. Këto karakteristika, të kuptueshme dhe të lejueshme deri diku për shkak të situatës, në të cilën krijohen dhe reflektojnë, dalngadalë shndërrohen në tregues të angazhimit ideologjik e politik të krijimtarisë së kësaj periudhe. Bile arrijnë deri në shfaqjen hapur të luftës së klasave. Këto elementë në të ardhmën do të bëhen mbisunduese dhe do të përbëjnë treguesin themelor të letërsisë së realizmit socialist.

Nqs “lufta” në këngët e traditës na jepet në realitetin e vet të vrazhdë dhe heroik, por pa një qëllim të përcaktuar, në krijimet e periudhës së luftës jepet nën prizmin e një qëllimi të qartë ideologjik. Lufta tani bëhet për “... Για μια λαοκρατία, για ένα μέλλον λαμπρό/ ελευτεριά ειρήνη, δουλειά, πολιτισμός»

(Për një demokraci, të ardhme të ndritur/ paqe, punë liri, civilizim...)

Ose “... Ποιος είδατε το Γιώργαρο /το Γιώργαρο το Ζώτο/ τον κλέφταρο τον πρώτο./μερόνυχτα τον βλέπαμε/ το Ζώτο τη φαγάνα/ την παλιοκαραβάνα.....»

(Kush pa Jorgaron/ Jorgaron Zoton/ Natë e ditë e shihnim/ Zoto llupësin/ çanakprishurin..)*

Janë pikërisht këto trajtesa që zbehin në maksimum vlerën letrare të këtyre poezive.

Nga ana stilistike në to ruhet vargu 15-rrokësh apo dhe 13-rrokësh, klasik apo i thyer, me ritëm jambik. Këto janë karakteristika kryesore të poezisë tradicionale popullore greke, por edhe të poezisë së kultivuar të autorëve të minoritetit grek për këtë periudhë dhe për dekada të tëra të periudhës së pasluftës. Përpjekjet për të futur në to rimën nuk janë dhe aq të suksesshme.

* Fjala është për një figurë intelektualë nga minoriteti që nuk u pajtua me idetë komuniste dhe për këtë u përmoq. Të njëjtin qëndrim mban ndaj tij dhe prodhimi letrar i kohës

Po ashtu, dëshmtitarë të letërsisë së kësaj periudhe tregojnë se gjatë luftës janë lëvruar dhe skica e tregime si dhe pjesë të vogla teatrale. Ato janë mënjanuar dhe në emër të “harresës” sot nuk disponohen. (Të vetme krijime që u ruajtën janë disa skica dhe tregime të vogla të Lefter Talos, të cilat faktikisht nuk lidhen me luftën, por me periudhën para saj.)

Për zhvillimin e kësaj letërsie u përdorën dy “gazeta” shaptilografi, njëra me emrin «Ο Αγώνας μας» (“Lufta jonë”) dhe tjetra «Η φωνή του αντάρτη» (“Zëri i andartit”)

Siç shihet, natyra dhe fizionomia e kësaj letërsie, e mbështetur kryesisht te krijimtaria e traditës popullore, krijuan përshtypjen se letërsia e luftës së minoritetit grek shenon dhe fillimet e letërsisë në minoritetin grek në Shqipëri. Kjo përshtypje u kthye në një të vertetë të paverifikueshme dhe ndihmoi shumë nevojat e politikës komuniste për të mohuar traditën ekzistuese letrare që trashëgoi Minoriteti Grek në Shqipëri. U shfrytëzua për këtë parimi i njohur se fillesat e çdo letërsie të kultivuar e kanë zanafillën te krijimtaria popullore.

Nga ana tjetër letërsia e Minoritetit Grek (lexo poezia) e kësaj periudhe, ashtu siç ndodhi edhe me letërsinë shqiptare, u trajtua me termat e folklorit, si krijime popullore (këngë) të luftës partizane. (Kjo ndodh edhe për arsyen e thjeshtë se ato krijoheshin për t’u kënduar, pra për t’i sherbyer moralit të luftës) Kështu, për këto poezi përdoret termi “këngë partizane” në shqip, ndërsa në greqisht edhe “Këngë andartësh” (*Αντάρτικα τραγούδια*).

Duhet thënë gjithashtu, se pavarësisht nga shkalla e mbështetjes në traditën popullore, në krijimtarinë në shqip apo greqisht, identifikimi me krijimtarinë popullore ose me një formë të përafërt me të (Këngë partizane – e të gjithë popullit që luftoi për liri nën drejtimin komunist) bëhet edhe me një qëllim tjetër. Për të vertetuar se fryma komuniste dhe pasqyrimi i saj në art përbënte shkallën më të lartë “të natyrës apo të frymës popullore”, karakteristikë që do ta hasim në vijim në gjithë letërsinë e pasluftës së popullit shqiptar edhe në krijimtarinë e kultivuar të minoritetit grek.

Në sherbim të së njëjtës ide, që letërsia e luftës së minoritetit grek shenon dhe fillimet e letërsisë në lidhje me minoritetin grek në Shqipëri, përdoret edhe fakti se letërsia e pasluftës në minoritet, krahasimisht me letërsinë e krijuar nga autorë minoritarë grekë brenda territorit shqiptar në periudhën para luftës, pati një zhvillim të vrullshëm.

Këto dhe arsyet e tjera i bënë ata pak studiues të periudhës së diktaturës komuniste të letërsisë në minoritet, të trajtonin krijimtarinë e periudhës së luftës si fillime të një letërsie të re, “të letërsisë minoritare”.

Në kritikën e kohës, krijuesit e periudhës së luftës u quajtën “njëzë të cilët ose nuk kishin asnjë lidhje me poezinë e kultivuar, ose kishin ndonjë njohuri lidhur me kërkesat e poezisë”¹⁵. Bile, këtyre marrëdhëniesve të krijuesve të kësaj periudhe me letërsinë, u dedikohen edhe elementet e poezisë së kultivuar që hasen, sipas mendimit kritik në fjalë, në krijimtarinë e periudhës së luftës. Madje, përpjekja e Pano Çukës në librin e tij “Një buqetë me këngë popullore” dhe të tjerëve pas tij, që flasin për emra konkret krijuesish të këtyre këngëve, konsiderohet e gabuar¹⁶. Ndodh kështu kur dihet që një pjesë e mirë e këtyre krijuesve si vetë Panos Çukas apo Spiros Xhas, Janis Panos, Vagjelis Vasiliu etj, u bënë krijuesit më në zë në letërsinë e mëvonshme në minoritetin grek në Shqipëri.

¹⁵ J. Jani, Gazeta «Λογοτεχνικό Λαϊκό Βήμα», nëntor, 1989, fq. 6.

¹⁶ J. Jani, Gazeta «Λογοτεχνικό Λαϊκό Βήμα», nëntor, 1989, fq. 6.

Bibliografi

- Nika V. (1988), Δημοτικά Τραγούδια της Ελληνικής Μειονότητας, Tiranë.
Kapsomenos. E. (2002), Αναζητώντας το χαμένο Ευρωπαϊκό Πολιτισμό, Athinë.
Akademia e Athinës, (1962), Ελληνικά δημοτικά τραγούδια, v.1, Athinë.
Hamon P. (1984) Texte et ideologie, Paris.
Eco U. (1966), “James Bond: une combinatoire narrative”, Athinë.
Gazeta «Λογοτεχνικό Λαϊκό Βήμα», nëntor 1989, fq. 6.
Barka P. (2003), Letërsia në Minoritetin Etnik Grek, Tiranë.

Kostando Ksera, Harallamb Miconi

5) Revista periodike “Kërkime Universitare”, Universiteti i Gjirokastrës, nr. 37, 2014

“Leksikografia shqiptaro – greke në fjalorin e Niko Gjinit (1971)”

Abstract

In the context of this paper we make an approach to the Albanian-Greek Dictionary edited by Niko Gjini and published in 1971 by the School Book Publishing House.

The main goal of his compiling the dictionary was to help the students of the Greek Ethnic Minority in Albania to better assimilate Albanian language so that they could integrate into Albanian society as soon as possible. Another aim was to help translators with their work.

In this study we examine the macrostructure and the microstructure of the dictionary, various details which characterize it and which distinguish it from other dictionaries and we make general remarks on the way it has been edited by the author.

The dictionary contains about 16.000 entries of the Albanian language vocabulary. Specific terminological words are not included in this dictionary.

Key words: Albanian-Greek dictionary, macrostructure, microstructure, vocabulary, entry, word correspondence

Leksikografia greko-shqiptare dhe ajo shqiptaro-greke e para viteve '90 ka qenë një fushë jo shumë e zhvilluar. Themelet e saj janë vënë në shekullin e XVIII¹⁷ dhe në fillimet e shekullit XIX¹⁸, por pas asaj periudhe konstatohet një mungesë interesimi për hartimin e fjalorëve të këtij lloji. Situata ndryshoi pas viteve '90 ku vihet re një lëvizje e veçantë në këtë fushë, e cila u dedikohet më shumë kushteve politiko-shoqërore sesa atyre linguistiko-akademike që mbizotëruan pas rënies së diktaturës komuniste.

Fjalorët e parë që u hartuan ishin greqisht-shqip dhe kjo ndodhi jo si rezultat i interesit leksikografik, por në kuadrin e mësimdhënies për shtrirjen dhe përhapjen e gjuhës greke.

Gjatë shekullit XX kemi përpjekje sporadike për hartimin e fjalorëve, por vepra më e rëndësishme dhe e para e llojit shqip-greqisht është fjalori i Kostandin Kristoforidhit që u botua në Athinë në vitin 1904. Edhe pse në botimin e tij të parë

¹⁷Fjalori i parë ku shqipja vihet përballë greqishtes është fjalori tregjuhësh, greqisht, vllahisht, shqip të Th. Kavaliotit (1770) i përfshirë në veprën e tij Protopeiria (Πρωτοπερία).

¹⁸ Fjalori katërgjuhësh (Λεξικόν τετράγλωσσον) i katër dialekteve popullore apo të romejës së thjeshtë, vllahishtes së Moisiat, të bullgarishtes dhe të shqipes, i përfshirë në veprën Hyrje në mësimdhënie «Εισαγωγική διδασκαλία» të Daniil Voskopojarit, (1802) dhe fjalori «Λεξικόν της Ρωμαϊκής και Αρβανιτικής Απλής» (Fjalor greqisht – arvanitshe e thjeshtë) i Marko Boçarit (1809).

fjalori titullohet *Leksikon tis allvanikis glossis*,¹⁹ «është pranuar se fjalori është në përgjithësi dygjuhësh, shqip-greqisht, ku greqishten e përdori si mjet shpjegues. Vepra zakonisht ka fjalën shqipe dhe përkrah saj fjalën gjegjëse të greqishtes.²⁰»

Fjalori shqip-greqisht i botuar nga Nikollaos Tsetes në Athinë më 1959 me 235 faqe është rasti i parë i ndërmarrjes së një iniciative të tillë nga autorë grekë.

Gjatë viteve të diktaturës vërejmë përpjekjet e para në Shqipëri për hartimin dhe botimin e fjalorëve shqip-greqisht. Shkaku kryesor i kësaj ndërmarrjeje ishte ekzistenca e minoritetit etnik grek dhe politika asimiluese që ndiqte shteti shqiptar për arsimimin e këtij minoriteti²¹.

Konkretisht në vitin 1971 kemi botimin e “*Fjalorit shqip-greqisht*” të Niko Gjinit dhe në vitin 1986 “*Fjalorin shqip-greqisht*” të Vasil Partalit. Që të dy janë botime të Shtëpisë Botuese të Librit Shkollor.

Fjalori i N. Gjinit është përpjekja e parë për të hartuar një fjalor dygjuhësh shqip-greqisht i përdorshëm në masë të gjerë. Autori me meritat e tij dhe dashurinë për të dyja gjuhët na ka dhënë një vepër shumë të rëndësishme për kohën në të cilën fjalori u hartua dhe u botua. Mungesa e fjalorëve analogë midis shqipes dhe greqishtes e vështirësonte shumë punën e autorit, por nuk e pengoi të krijonte një vepër të cilësisë dhe parametrave bashkëkohore.

Qëllimi i hartimit të fjalorit

Edhe pse nga fjalori mungon një tekst ku të sqarohet qëllimi i hartimit të tij, duke u nisur nga rrethanat në të cilat u hartua, nga kushtet politiko shoqërore që mbizotëronin në atë periudhë si dhe nga fakti që fjalori është botim i Shtëpisë Botuese të Librit Shkollor mund të themi se qëllimi kryesor i fjalorit është:

- Që t’u vijë në ndihmë nxënësve të shkollave të minoritetit të cilët ishin njëgjuhësh, greqishtfolës²² për të përballuar vështirësitë që ata gjenin gjatë kalimit nga cikli fillor në atë 8-vjeçar,²³ sidomos për të përballuar terminologjinë shkencore të teksteve shkollore.

- Njëkohësisht ai u vinte në ndihmë përkthyesve të veprave të letërsisë shqipe në greqisht për nevojat e komunitetit grek dhe sidomos për nevojat e shkollës si dhe hartuesve dhe përkthyesve të teksteve shkollore për minoritetin etnik grek.

- Një qëllimi tjetër, siç duket edhe nga parathënia e prof. Zihni Sakos është që t’u vijë në ndihmë përkthyesve dhe gazetarëve për t’i arritur qëllimit që fjala e shokut Enver Hoxha dhe direktivat e Partisë dhe të ideologjisë socialiste të arrinin tek të gjithë njerëzit edhe te komuniteti grek.

¹⁹ Fjalori u ripunua nga A. Xhuvani dhe u transkriptua në alfabet shqip. U botua në Tiranë në vitin 1961 me titullin «Λεξικόν Αλβανο – Ελληνικόν» (Fjalor shqip – greqisht).

²⁰ Sofia Delijorgji, 2011, Tiranë, Disertacion, Rreth interferencave leksiko – semantike të greqishtes në shqipë, faq. 141.

²¹ Për më shumë shih v. Bici. *Çështje të dygjuhësisë në shkollat e pakicave*, Tiranë, 2001.

²² Anëtarët e Minoritetit Etnik grek në Shqipëri para se të venë në shkollë janë monoling me gjuhë amtare greqishten. Në klasën e parë fillojnë mësimin e gjuhës shqipe në fillim si gjuhë e huaj dhe në vazhdim si gjuhë e dytë.

²³ Mësimet zhvilloheshin të gjitha në gjuhën shqipe përveç mësimin të Gjuhës dhe Letërsisë greke, që zhvillohej në gjuhën amtare, me dy orë në javë.

- Fjalori ishte i nevojshëm edhe për një pjese intelektualësh (studiues të ndryshëm, shkrimtarë, linguistë etj.) shqiptarë të cilët kishin interes për gjuhën dhe krijimtarinë greke si të kohëve të vjetra ashtu edhe të kohëve moderne²⁴.

- Nuk mund të lihet jashtë as ambicia filologjiko-linguistike e vet autorit për të krijuar një fjalor dygjuhësh midis shqipes dhe greqishtes²⁵. Ambicia e tij e gërshetuar me “vijën” e Partisë na dhanë veprën e rëndësishme për të cilën bëhet fjalë.

Makrostruktura e fjalorit²⁶

Fjalori ka rreth 16.000 fjalë në gjithsej 551 faqe të formatit 60X88/16. Ai fillon me «dy fjalë» nga drejtori i Institutit të Folklorit, prof. Zihni Sakos të përkthyer edhe në gjuhën greke. Prof. Zihni Sako thekson se paralel me ngritjen kulturoro-ekonomike të shoqërisë shqiptare kemi edhe arritje në fushën e hartimit të fjalorëve dygjuhësh, të cilët nxjerrin në dritë pasurinë e madhe të gjuhës shqipe. Kjo gjë ndodh edhe në përballjen e saj me greqishten. Ai vë në dukje edhe mungesën e fjalorëve të përgjithshëm të gjuhës shqipe të përdorshëm për një masë të gjerë njerëzish.

Në faqen 9 fjalori përmban në greqishte shënime në lidhje me përdorimin e tij. Më pas ka një listim alfabetik të fjalëve të shkurtuara. Vazhdon me alfabetin e gjuhës shqipe dhe shqiptimin e shkronjave në greqishte. Më pas na jep informacion gramatikor në lidhje me ndarjen dhe shqiptimin e shkronjave si dhe shenjat e pikësimit dhe të theksimit.

- Në bibliografinë e faqes 21 vërejmë që vepra kryesore në të cilën është bazuar autori është fjalori i Kostandin Kristoforidhit (1904 dhe 1961). Në fakt është fjalori i vetëm greqisht-shqip që ekzistonte gjer atëherë. Fjalori i Kristoforidhit përmban 12.000 lema, kurse ai i Gjinit rreth 16.000 lema. Kjo na detyron të mendojmë se autori i është referuar edhe “*Fjalorit të Gjuhës Shqipe*” (1954) për renditjen e lemave.

- Ajo që vihet re është se Gjini nuk dispononte²⁷ të gjithë fjalorët e gjuhës greke që janë botuar deri atëherë, por vetëm ata që janë gjetur rastësisht afër tij. Mungojnë nga bibliografia fjalorët më të përdorshëm dhe më të plotë të gjuhës greke, siç janë fjalori i Proias²⁸ dhe i Stamatakos,²⁹

- Fjalorët që disponon i perkasin periudhës së para Luftës së Dytë, dmth., para izolimit të Shqipërisë nga bota përreth. Vetëm tre nga këta janë të viteve 1961, 1962, 1971. Fjalorët greqisht-rusisht ose rusisht-greqisht janë të gjitha botime në Moskë.

- Pjesa e lemave përmbahet në faqet 25-495, dmth., zënë 470 faqe.

²⁴ R. Bumi, J. Ricos, N. Kazanxakis, M. Llundemis, etj. janë nga autorët që njiheshin më shumë në Shqipëri dhe përkthimi i veprave të tyre i vinte në ndihmë ideologjisë socialiste.

²⁵ Në vazhdim Niko Gjini krijoi dy vepra jete që janë Fjalori Greqisht – Shqip, Janinë, 1993 dhe Fjalori Shqip – Greqisht, Janinë 1998.

²⁶ Është ndërtimi i fjalorit në tërësi.

²⁷ Mungesa për shkak të izolimit dhe të mos ekzistencës së mundësisë për të komunikuar me vendet përreth.

²⁸ Proia, «Λεξικόν της Νέας Ελληνικής γλώσσας», Athinë, 1933.

²⁹ Stamatakos, «Λεξικόν της Νέας Ελληνικής, Καθαρευούσης και Δημοτικής», Athinë 1952 - 55.

- Më pas ka një listim alfabetik të emrave gjeografikë. Janë kryesisht emra shtetesh, kryeqytetesh, qytetesh të Shqipërisë dhe të Greqisë si dhe vende të rëndësishme gjeografike, dete, lumenj, liqene, etj.
- Fjalori vazhdon me shkurtesat e gjuhës shqipe dhe të huaja.
- Fjalori mbaron me shembuj zgjedhimesh të foljeve ndihmëse, në shqipe dhe greqishte, si dhe të foljeve të parregullta në të gjitha kohët, diatezat dhe mënyrat.

Mikrostruktura e fjalorit³⁰

Fjalësi në shqip

Edhe pse fjalori u botua një vit para se gjuhëtarët shqiptarë të organizonin Kongresin e Drejtshkrimit për Unifikimin e Shqipes, Gjini ka meritën e dhënies të lemave shqipe saktë fonetike (dhe nga ana tingullore dhe nga ana e theksave).

Lemat në shqipe jepen në mënyrë alfabetike me shkronja të theksuara dhe në krahasim të tyre jepet me shkurtime kategoritë gramatikore ku bën pjesë fjala. P.sh., **agresor-i**, ουσ. **dekadent-e**, επιθ.

Emrat janë vënë në trajtën e pashquar dhe më pas jepet mbareja e trajtës së shquar, kurse për emrat që kanë tipa të ndryshëm për çdo trajtë jepet e gjithë fjala edhe në trajtën e shquar. Pas asaj jepet gjinia e emrit dhe më pas mbareja e shumësit.

Për mbiemrat shënohet tipi i gjinisë mashkullore dhe në vazhdim pas vijës mbareja e gjinisë femërore. Për mbiemrat e nyjshëm pas kësaj jepen në kllapa nyjat. Në greqishte jepet vetëm tipi i mashkullores.

Foljet jepen në vetën e parë të kohës së tashme njëjës, mënyra dëftore dhe në vetën e tretë foljet pavetore. Pas kategorisë së foljes jepet nëse folja është kalimtare ose jo kalimtare. Forma pësore e foljes nuk përbën lemë më vete, por jepet brenda lemës së formës veprare për ato folje që kanë edhe formë pësore, si p.sh., *sqaroj-sqarohem, thaj-thahem, mundo-mundohem*.

Theksimi i lemave në shqipe bëhet vetëm kur theksohet rrokja e fundit ose e tretë nga fundi.

Në lemat nuk përfshihen fjalë të përdorimit shumë specifik sepse fjalori nuk pretendon të bëhet një fjalor i gjithë pasurisë së gjuhës shqipe. Përveç fjalëve që gjenden në bërthamën e gjuhës shqipe, në fjalor përfshihen edhe fjalë të prejardhura (me parashtesa ose prapashtesa) ose të përbëra nga to (kompozitë e parë ose e dytë).

Lemat janë të gjuhës letrare shqipe dhe nuk përfshihen në to fjalë që u përkasin dialektit tosk ose geg, përveç atyre që kanë përdorim unik.

Në lemat e shqipes nuk dallojnë ato që janë në përdorim të gjerë nga ato që kanë karakter historik, dmth., të cilat nuk përdoren më.

Fjalët homonime jepen si lema të veçanta.

Në raste të rralla si lema përdoren shprehje, si p.sh., **besa-besë**, ἀκλιτη λέξη, si p.sh., u lidhëm me **besa-besë** (fq.50); **kashë e lashë**, ἀκλιτη λέξη, το αίνιγμα (fq. 187).

³⁰ Mikrostruktura e fjalorit është ndërtimi i çdo njësie leksikografike veças, d.m.th. paragrafi për një fjalë ose për njësi frazeologjike, ai që quhet «zë leksikografik» ose «paragrafi i fjalës».

Shpjegimi i fjalës në greqisht

- Fjalët korresponduese të greqishtes dhe shpjegimi i lemave bëhet në gjuhën popullore greke (dhimotiki), edhe pse gjuhë zyrtare e shtetit Grek në atë periudhë ishte gjuha intelektuale (katharevusa), e cila u zëvendësua nga gjuha popullore me vendim të Parlamentit Grek në vitin 1976. Në raste të rralla fjalët sinonime të greqishtes u përkasin fazave të ndryshme historike. P.sh. **çadër-çadra** ομπρέλα, το αλεξιβρόχιο, το αλεξήλιο;³¹ **gravitet-i** το βάρος, η βαρύτητα, η βαρύτης (fjalë arkaike); **greminë-a** ο γκρεμός, ο κρημνός (fjalë arkaike).

- Për emrat e bimëve dhe të kafshëve jepet termi shkencor në latinishte, si p.sh., **bathë-a**, ουσ. θ. πληθ.-, Βοτ. (*Vicia faba*) το κουκί. **merimangë-a**, ουσ.θ. Ζωολ.(*Aranea*) η αράχνη

- Jepet informacion në lidhje me fushën e përdorimit të fjalës: shkencë, art, mjekësi etj., nëpërmjet shkurtesës e cila fillon me shkronjë të madhe, si p.sh., **elasticitet-i**, ουσ. αρ. Φυσ. (Fizikë), **eksponent-i**, ουσ. αρ. Μαθ. (Matematikë).

- Para shpjegimit në gjuhën greke sqarohet në kllapa nëse. fjala përdoret me kuptim metaforik, e përfshirë në shprehje apo në proverb. P.sh., shpirt-i, **Μ ε τ φ. me mish e me shpirt**, ψυχή τε και σώματι.

- Theksimi bëhet me sistemin e theksimit me shumë theksa. Sistem që u zbatua në shkrimin e greqishtes deri në vitin 1981.

- Shpjegimi i lemës shqipe bëhet kryesisht me vendosjen e fjalës analoge të greqishtes dhe të sinonimeve të saj. Në raste të rralla, kur nuk mjafton fjala analoge, jepet një shpjegim i thjeshtë i fjalës, i cili bëhet me *perifrazim* dhe në disa raste me formulën *ai që*. Në raste të tjera fjala vendoset në togfjalësh dhe menjëherë pas tij jepet togfjalëshi analog në greqishte. Shprehjet janë zakonisht ato të përdorimit të gjerë si në shqipe edhe në greqishte të cilat i krijon vetë autori. Nuk kemi ilustrime të mara nga tekste letrare ose publicistike. Në ilustrimet nuk ndeshim shpesh proverba ose shprehje frazeologjike. Ato jepen në rastet ku shprehjet gjenden identike në të dyja gjuhët, si p.sh., me fjalë e me të bëme = με λόγια και με έργα.(51)

- Kuptimet e ndryshme të një fjale jepen me numra, kurse kuptimet e përafërta ndahen me presje. Renditja e këtyre fjalëve bëhet sipas kuptimit të tyre, i pari jepet kuptimi i përgjithshëm ndaj atij specifik, kuptimi kryesor ndaj atij metaforik, ai që përdoret më shpesh nga ai që përdoret më rrallë, si p.sh., **shpërngulje-shpërngulja**, ουσ. θ. πληθ.-, η εκτόπιση, η μετατόπιση, η μετακίνηση, η μετακόμιση, η μετοικεσία, η μετανάστευση.

Vërejtje rreth fjalorit

Hartimi i fjalorëve dygjuhësh nuk është punë e lehtë siç mund t'i duket dikujt që nuk i njeh vështirësitë e punës leksikografike. Vështirësia më e madhe që hasin hartuesit e këtyre fjalorëve buron nga fakti se fjala ka valenca të ndryshme në gjuhë të ndryshme. Për rrjedhojë, zgjedhja e barasvlerësve së kuptimeve dhe të ngjyimeve kuptimore për çdo fjalë që përkthehet në gjuhën tjetër kërkon shumë mund. Jo më pak

³¹ Fjalët αλεξιβρόχιο dhe το αλεξήλιο ishin përpjekje të vjetra të intelektualëve për të zëvendësuar fjalën e huaj *ombrella*, të cilat nuk mbijetuan me kalimin e kohës.

e vështirë është dhe pajisja e fjalorit me frazeologjinë e duhur dhe me shembuj, ku të ilustrohen kuptimet e ndryshme të fjalës.³²

Për vetë natyrën e fjalorit, si fjalor jo i madh, Gjini është mjaftuar në dhënien e deri dy kuptimeve të fjalëve. Janë të rralla rastet që autori e tejkalon këtë numër. Në disa kjo raste krijon probleme në lidhje me përcaktimin e kuadrit kuptimor të fjalës. Le të marrim si shembull fjalën shqipe *kohë*, një nga fjalët polisemantike më problematike e cila nuk është pasqyruar mjaftueshëm në fjalor.

Kështu, në fjalor nuk bëhet dallimi midis kuptimit “εποχή = periudhë kohore” nga kuptimi “καιρός = mot” si kuptime të ndryshme korresponduese të fjalës “kohë”.

Duhet shtuar kuptimi korrespondues “χροнос” për kuptimin e përgjithshëm të fjalës “kohë”.

Përveç kuptimit terminologjik gramatikor “χροнос” të fjalës “kohë”, duhet shtuar edhe kuptimi korrespondues “χροнос” për kuptimin terminologjik fizik, filozofik etj.

Duhet shtuar kuptimi korrespondues “ώρα” si dhe kuptimi korrespondues “περίοδος” për kuptime të tjera të fjalës “kohë”.

Pra, kuptimet e fjalës shqipe “kohë” do të mbuloheshin në mënyrë më të plotë në greqishte duke u përkthyer me të gjitha fjalët greke καιρός, χροнос, εποχή, περίοδος dhe ώρα të përfshira, secila prej tyre ose disa prej tyre së bashku, në kuptimet e veçanta të fjalës shqipe “kohë”, si p.sh.:

-kohë = χροнос, καιρός, për: *Pa humbur kohë. Kërkon (do) kohë etj.*

-kohë = χροнос, për: *Koha është flori etj.*

-kohë = εποχή, καιρός, për: *Që nga ajo kohë. Iku ajo kohë etj.*

-kohë = εποχή, për: *Në kohët e kaluara/e ndritura/e lashta etj.*

-kohë = περίοδος, καιρός, për: *Në kohë paqeje/luftë. Kohët e fundit etj.*

-kohë = περίοδος, për: *Koha e rinisë etj.*

-kohë = καιρός, për: *Kohë e mirë/e keqe/e ngrohtë/e thatë. Kohë e bukur etj.*

-kohë = ώρα, për: *Në kohën e drekës/e gjumit. Para kohe. Është koha të... etj.*

-kohë si terma në fusha të ndryshme: fil., fiz., gjuh. etj.= χροнос.

Në fjalorin e vitit 1998 gjejmë 13 kuptime të fjalës *kohë*.

Në disa raste autori nuk u shpëton kalkimeve idiomatike nga shqipja në greqishte, të cilat janë të pajustificuara në gjuhën letrare të atdheut mëmë (greqishtes). Kështu për të shpjeguar idiomat e shqipes: **s’çan kokë**: δεν σκοτίζεται, δεν σχίζει το κεφάλι; **më vjen mirë**: ευχαριστιέμαι, μου’ρχεται καλά, do të ishin të mjaftueshme shpjegimet e dhëna δεν σκοτίζεται dhe ευχαριστιέμαι respektivisht dhe është e gabuar dhe e tepërt përpjekja për të gjetur ekuivalente idiomatike për to, si p.sh., δεν σχίζει το κεφάλι dhe μου’ρχεται καλά. Këto idioma përbëjnë shprehje të të folurës së grekëve të Shqipërisë. Shprehje të tilla janë krijuar si përkthime fjalë për fjalë të shprehjeve frazeologjike të shqipes dhe kanë kaluar në gjuhën e grekëve të Shqipërisë në përdorim të gjerë, si p.sh., *u bë bërryl, mëthuσε, έγινε τάπα* (në greqishten zyrtare nuk ekziston si shprehje, vjen nga shqipja *u bë tapë*);

Shprehje dhe fjalë të krijuara në greqishte nëpërmjet shqipes gjejmë edhe në raste të tjera, si p.sh., **shko ca më tutje** = πήγαυε λιγάκι **παρέκει**, në vend të πήγαυε

³² Dua libra. dualibra.com/leksiku-dhe-shtresimi -i-tij/

λιγάκι πιο κει (në fjalorin e 1998-ës e gjejmë të korrigjuar), kurse çere-ja = **τσιερός**; callangur-i = **το σκιλιμπόνι** nuk gjendet fare në fjalorin e 1998-ës.

Problemet e mësipërme vijnë si arsye e humbjes së kontaktit të autorit me greqishten e folur si dhe e përdorimit të shqipes në të gjitha fushat e jetës së përditshme.

Në parathënien e fjalorit greqisht-shqip të Marko Boçarit, prof. Johallas shkruan për fjalorin e vitit 1971 të Gjinit: «Në këtë fjalor përfaqësohet gjuha shqipe e sotshme, unike, e folur dhe e shkruar. Për sa u përket shpjegimeve në gjuhën greke vëren dikush se leksikografi nuk e njeh greqishten në nivelin e duhur ose të paktën nuk ka kontakte direkte me greqishten e re unike të folur.»³³

Për termin *Ministria e Shëndetësisë* jep në greqisht përkthimin nga shqipja *Υπουργείο της Υγεινής* dhe jo termin që përdoret gjerësisht në greqisht *Υπουργείο Υγείας*.

Fjalë antonime ose me kuptim të kundërt shfaqen rrallë, vetëm në ato raste që antonimet janë shumë të përdorshme, si p.sh., shëmtuar (i,e)-bukur (i,e), shpesh-rrallë, shes-blej. Sinonimet e lemave shqipe jepen në mënyrë sistematike sikundër jepen edhe sinonimet në gjuhën greke.

Në fjalor gjejmë edhe disa fjalë, terma ose frazeologji që i përkasin botës fetare që është diçka jo e pritshme për atë periudhë, si p.sh., **shëndre-u** – Αγιαντριάς, muaji dhjetor; **kungë-a**, - το αγιοβήμα, το ιερό, ajodhima; **kreshmë**-νηστεία, **kreshmoj** – νηστεύω; **meshë-a** - 1. η λειτουργία, 2. το πρόσφορο;

Fjalët **shërbëtor-i** dhe **shërbëtore/ja**, i karakterizon si fjalë *të vjetruara* që nuk përdoren më. Kjo është një qasje ideologjike që i detyrohet kohës së hartimit të fjalorit. Të njëjtat fjalë në fjalorin e 1998 nuk i gjejmë si të vjetruara.

Konkluzione

Niko Gjini falë durimit dhe mjeshtërisë së tij diti të shfrytëzojë në maksimum materialet e pakta që dispononte dhe hodhi bazat e leksikografisë moderne shqiptaro-greke, të cilat në vazhdim vet ai i ngriti në nivelet më të larta me veprat e tij madhore, Fjalorin greqisht-shqip të vitit 1993 dhe Fjalorin shqip-greqisht të vitit 1998.

Fjalori i vitit 1971 është një produkt i kohës së vet dhe i kushteve politiko shoqërore të cilat mbizotëronin në atë periudhë.

Hartimi i fjalorëve, dhe sidomos i fjalorëve dygjuhësh është një punë e vështirë dhe e ndërlikuar. Vështirësia bëhet edhe më e madhe kur nuk ekzistojnë monopate mbi të cilat të ecësh, por duhet t'i çelësh vetë, ashtu siç veproi Niko Gjini. Ai si shërbëtor i leksikografisë dhe njohës i mirë i shqipes dhe i greqishtes, diti të punojë me përkushtim dhe arriti të na japi një vepër shumë të rëndësishme. Fjalori shqip-greqisht i Gjinit për vite të tëra përbënte pikë referimi jo vetëm për breza të tërë nxënësish, por edhe për mësuesit dhe përkthyesit.

Zhvillimi shumë i shpejtë i teknologjisë në të gjithë fushat e veprimtarisë njerëzore, në të gjithë botën, krijon përditë terma të rinj shkencorë të cilët detyrojnë leksikografinë të hartoj fjalorë të rinj herë pas here. Kjo duket qartë edhe në fjalorin e

³³ Titos Johallas, *Πραγματεία της Ακαδημίας Αθηνών*, τόμος 46, 1980, Το ελληνο-αλβανικό λεξικόν του Μάρκου Μπότσαρη, Αθήναι 1980, εισαγωγή.

Gjinit (1971) duke e krahasuar me atë të 1998. Në një krahasim rastësor të numrit të fjalësit të shkronjës «N», në fjalorin e vitit 1971 kemi rreth 526 fjalë kurse në atë të vitit 1998 rreth 1200 fjalë.

Bibliografi

Akademia e Shkencave, Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, 1980.

Bici, V., *Çështje të dygjuhësisë në shkollat e pakicave*, Tiranë 2001.

Babinjotis, J., «Λεξικό της Νέας Ελληνικής Γλώσσας», Αθήνα, 1998.

Delijorgji, S., 2011, Tiranë, Disertacion, Rreth interferencave leksiko – semantike të greqishtes në shqipë.

Gjini, N., Fjalori Shqip – Greqisht, Tiranë 1971.

Gjini, N., Fjalori Shqip – Greqisht, Janinë 1998.

Johallas, T., Πραγματεία της Ακαδημίας Αθηνών, τόμος 46, 1980, Το ελληνο-αλβανικό λεξικόν του Μάρκου Μπότσαρη, Αθήναι 1980.

6) “International Journal of Linguistics”, March 2014

“Bilingualism and the alternation of codes in a bilingual environment”

The term *diglossia* (Ferguson 1959) in Greek is assigned as social bilingualism dimorphic or dialecticism (Kakridis 1986, Papapavlou 1998) to be contrasted with the term bilingualism (bilingualism). Although the relationship between the two situations is often extremely complicated, as it can coexist (Fishman 1980), the basic distinction between bilingualism and social bilingualism concerns their conquest procedures, and other functional differentiation and social prestige of the two varieties. Thus, the term bilingualism (bilingualism) refers to the physical conquest of two languages as mother tongue, usually in *personal* level (ex. children whose parents have different native languages or immigrant children), without the necessity of a systematic differentiation of the one and the other in what concerns the language functions they perform, and without necessarily hierarchical distinction from each other in their social prestige. Conversely, the term social bilingualism (*diglossia*) describes, in accordance with Ferguson, a relatively stable linguistic situation in which, beside the basic dialects of the language (which may include a predominant variety or different local predominant varieties), there is a quite different, strictly codified (often more complex grammatically) overlying variety, which disposes a big and respected grammar, deriving either from an earlier time or another language community, which is mostly learned through formal education and is used in most aspects of writing and formal communication but not used by any group of population in everyday communication.

The definition that is now considered generally acceptable was delivered by Weinreich and defines bilingualism as an alternative *ability of using two linguistic codes* and as *bilingual* the individuals occupying this property. Therefore, bilingualism is generally called the capacity of an individual to speak two different languages. To alternatively handle at least two independent communication codes.

So it is understood that the advantage of the definition given by Weinreich in bilingualism is that it distinguishes bilingual from monolingual people. By this way the boundaries of bilingualism are expanded indefinitely, as each person using a second code of communication is designated as bilingual regardless of the degree of possession or use of opportunities available of the foreign language system.

Before we attempt a further analysis of the issue, we believe that first it is necessary a general reference to the manner and the circumstances in which an individual learns the foreign languages.

First, the knowledge of a single code of communication, namely the exclusive possession of the mother tongue, is called monolingualism and it is a widespread property in advanced countries in which multilingual people are considered as something extraordinary or at least as something unusual.

But in many parts of the world the ability to use several languages is regarded as something very natural and self-evident. In societies or in environments monolingual individuals might classify and be treated as a disadvantage, since the monolingual person would not be able to communicate adequately with the environment and solve effectively all problems.

An interesting example of society with multilingual people is the case of the Toucan tribe (Tukano) which resides on the border between Colombia and Brazil. The Toucans are multilingual people, because men should marry women that do not talk their tribe language. This fact results in using a different number of languages in the community of Toucans. Children of this tribe are born and raised in a multilingual environment, where the native language of the mother is different from that of their father, of their grandmother and possibly different from that of their aunt.

Yet, people of the Toucans tribe are interested to learn each other's language in order to possess many codes and to communicate between them, just as effectively as it happens in a monolingual society. This phenomenon of using many languages is considered so natural, that speakers are aware neither of the fact that they speak many languages, nor of the remarkable ability to move from one code to another automatically without difficulties or problems.

There are several mentioned similar societies, where multilingualism is the norm, most of which are located in Latin America, Africa and Asia. In such societies, due especially to social and cultural conditions, multilingualism is not considered a danger to the overall coherence, but instead it is believed that strengthens and sustains existing social structures. For this reason, in contrast to the known language policy of developed countries towards minority groups that exist within them, these communities reinforce and reward through their social mechanisms, multilingualism.

According to the view of researchers who studied many multilingual societies of this type, these speakers use different codes that they possess to satisfy particular social needs. Multilingualism in these communities shows functional feasibility and, consequently, the separate linguistic codes work in this case as the various forms than the unique language in monolingual societies consists of. As a result people who live in multilingual societies acquire many codes simultaneously with the same ease and nearly in the same process, just as the children of monolingual societies acquire their native language.

The simultaneous acknowledgment of two or more languages is observed as an isolated phenomenon and in so-called developed societies, where some people are born and raised under particular conditions such as the case of the various minorities or children whose parents have different mother tongues. But for the vast majority of people born in developed countries (and usually monolingual societies) learning a foreign (or second) language is a conscious activity undertaken after the age of 7-8, at a time where they have already mastered the basic structures of the mother tongue. But in that case the learning of foreign languages is a process very different from that indicated in the acquisition of the mother tongue, and in fact these difficulties are numerous. There are few individuals who eventually manage to create a second communication code that functions autonomously and independently from the first (ex. mother tongue). Most of them subordinate the system of the foreign language into the structures of the mother tongue so to think and to face the new reality simply translating the latter in the foreign language.

Modern research has found benefits in children that come in contact with a second language system. In particular, these children acquire met linguistic consciousness against monolingual children, which probably facilitates the learning of the first reading and writing and leads to higher levels of school success. Another sector in which bilingual children may excel is the communicative sensitivity, as they are early forced to realize which language is suitable for communication for any occasion.

According to Skutnabb-Kangas (1988), monolingualism means monoculturalism. Consequently, a monolingual person sees things from a single point of view and can't see them from someone else point of view.

Language is not just a tool of arrangement or a means of communication but it represents the institution and the expresser of ideas, values and concepts, which means that learning a foreign language implies, to a certain extent, the simultaneous appropriation of the corresponding culture, i.e. a new and special way of approaching and viewing of reality.

Culture is generally a set of concepts, ideas, values, attitudes, thinking and action which characterize in a given time a human community. These facts aren't unrelated and unconnected between them, but they are an organized whole, which has a constitution, consistency and uniformity and its principles shape and affect unwittingly the behavior of the members of the Community.

